GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
P.Kr nr.18/14
PPS Nr. 38/09
Numri i gjykatës: GJPP Nr. 138/09
13 mars 2014

Aktgjykimi i publikuar mund te mos jete i formës se prere dhe munde te jetë objekt i ankesës ne baze te ligjit te aplikueshëm.

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore e Prishtinës në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Mariola Pasnik si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtarja e Kosovës Suzana Cerkini dhe Gjyqtarja e EULEX-it Marie Tuma si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga procesmbajtësi David Hegarty dhe Zeqir Shabani si përkthyes, në lëndën penale kundër:

| | |
|---|---|
| **Emri** | **S.** |
| **Mbiemri** | **T.** |
| **Emri i babait** | ... |
| **Data e lindjes** | ... |
| **Vendi i lindjes** | ... |
| **Gjinia** | Mashkull |
| **Adresa** | ... |
| **Kombësia** | Shqiptar |
| **Nënshtetësia** | Republika e Shqipërisë |
| **Nr. KI** | |
| **Profesioni** | Në pension |
| **Gjendja Ekonomike** | E dobët deri në mesatare |
| **Shkollimi** | 4 vite shkollë fillore |
| **Statusi Familjar** | I martuar, ka 5 fëmijë |
| **Procedura të tjera penale në zhvillim :** | Asnjë. |
| **Dënime të Mëparshme** | Asnjë. |
| **Paraburgimi dhe Statusi i Masave sipas kapitullit XXX** | Në paraburgim që nga 1 korriku 2011 |

I cili akuzohet me akuzat si në vijim

**PIKA 1**

**BLERJA, POSEDIMI, SHPËRNDARJA DHE SHITJA E PAAUTORIZUAR E NARKOTIKËVE TË RREZIKSHËM DHE E SUBSTANCAVE PSIKOTROPIKE, E KRYER NË BASHKË-KRYERJE**, në kundërshtim me nenin 229, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) në lidhje me nenin 23, dhe e dënueshme me një gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet, apo në mënyrë alternative, qëllimisht ka ndihmuar në kryerjen e kësaj vepre penale siç parashihet me nenin 25 të KPPK.

**SEPSE** ndërmjet 24 korrikut 2009 dhe 15 shtatorit 2009, S.T. ka kryer veprën e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike duke marrë pjesë në eksportimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës për eksport në vendet e Evropës Perëndimore duke përfshirë Zvicrën të një dërgese të heroinës si pjesëtarë të një grupi.

**PIKA 2**

**BLERJA, POSEDIMI, SHPËRNDARJA DHE SHITJA E PAAUTORIZUAR E NARKOTIKËVE TË RREZIKSHËM DHE E SUBSTANCAVE PSIKOTROPIKE, E KRYER NË BASHKË-KRYERJE**, në kundërshtim me nenin 229, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) në lidhje me nenin 23, dhe e dënueshme me një gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.

**SEPSE** në mes të datës 01 tetor 2009 dhe 25 nëntor 2009, S.T. ka kryer veprën e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike duke marrë pjesë në eksportimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës për eksport në vendet e Evropës Perëndimore duke

përfshirë Zvicrën, Holandën, Italinë dhe/ose Gjermaninë, të një dërgese me së paku 109kg cannabis sativa si pjesëtarë i një grupi.

**<u>PIKA 3</u>**

**KRIMI I ORGANIZUAR**, në kundërshtim me nenin 274 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPPK-së, e dënueshme me burgim prej së paku pesë vjet.

**SEPSE** ndërmjet 24 korriku 2009 dhe 25 nëntor 2009, S.T. në territorin e Kosovës kryen veprën e krimit të organizuar duke marrë pjesë aktivisht në veprimtari kriminale apo të tjera të grupit të organizuar kriminal së bashku me Xh.T., A.K., G.G., G.I., A.T., H.T., dhe bashkëkryerës të tjerë të paidentifikuar, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do të kontribuonte në kryerjen e veprave të rënda penale nga grupi i organizuar kriminal domethënë blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm nga Shqipëria në Kosovë dhe më tej në vendet në Evropën Perëndimore, *inter alia*, Slloveni, Itali, Gjermani, Zvicër dhe/apo Holandë.

**PAS** mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësorë në gjykim të hapur më 04 mars 2014, 11 mars 2014 dhe 12 mars 2014, në prani të të pandehurit S.T., avokatit të tij mbrojtës R.D. dhe në prani të Prokurorit Special të EULEX-it Charles Hardaway nga Prokuroria Speciale e Kosovës, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 12 mars 2014, në përputhje me nenin 391, paragrafi (1) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës ("KPPPK"), sipas nenit 392 paragraf (1) KPPPK dhe neneve 385, 386 dhe 387 të KPPPK-së, më 13 mars 2014, në gjykim të hapur dhe në prani të të pandehurit, avokatit tij mbrojtës dhe Prokurorit të EULEX-it nga Prokurorisë Speciale, Gjykata shqipton dhe shpallë këtë

---

**AKTGJYKIM**

---

**S.T.**, me të dhënat personale si më sipër, në paraburgim që nga 01 korrik 2011 është gjetur si në vijim:

Duke u mbështetur në nenin 389 paragrafi 1 të KPPPK-së,

**Pika 1**: **REFUZOHET** sepse Prokurori e ka tërhequr akuzën gjatë shqyrtimit kryesor;

Po ashtu, duke u mbështetur në nenin 391 të KPPPK-së,

**Pika 2**: **FAJTOR** për **BLERJE, POSEDIM, SHPËRNDARJE DHE SHITJE TË PAAUTORIZUAR TË NARKOTIKËVE TË RREZIKSHËM DHE E SUBSTANCAVE PSIKOTROPIKE, E KRYER NË BASHKË-KRYERJE DHE NË KUNDËRSHTIM** me nenin 229, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 i Kodit të Përkohshëm Penal Kosovës (KPPK) në lidhje me nenin 23 të tij,

**SEPSE** në mes të datës 01 tetor 2009 dhe 25 nëntor 2009, S.T. ka kryer veprën e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike duke marrë pjesë në eksportimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës për eksport në vendet e Evropës Perëndimore duke përfshirë Zvicrën, Holandën, Italinë dhe/ose Gjermaninë, të një dërgese me së paku 109kg cannabis sativa si pjesëtarë i një grupi.

Po ashtu, duke u mbështetur në nenin 391 të KPPPK-së,

**<u>Pika 3</u>**: **FAJTOR për KRIM TË ORGANIZUAR,** në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 2 të KPPK-së.

**SEPSE** ndërmjet datave 24 korrik 2009 dhe 25 nëntor 2009, S.T. në territorin e Kosovës ka kryer veprën e krimit të organizuar duke marrë pjesë aktivisht në veprimtari kriminale apo të tjera të grupit të organizuar kriminal së bashku me Xh.T., A.K., G.G., G.I., A.T., H.T., dhe bashkëkryerës të tjerë të paidentifikuar, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do të kontribuonte në kryerjen e veprave të rënda penale nga grupi i organizuar kriminal domethënë blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm nga Shqipëria në Kosovë dhe më tej në vendet në Evropën Perëndimore, *inter alia*, Slloveni, Itali, Gjermani, Zvicër dhe/apo Holandë.

**PRANDAJ,** për arsyet e mësipërme, Gjykata shqipton dënimin në vijim:

Duke qenë se është gjetur fajtor sipas Pikës 2 për Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike sipas nenit 3 paragraf 2 të KPK-së dhe nenit 229, paragrafi 4 i KPK-së, nenit 66 paragrafi 2, nenit 67 paragrafi 1 nën-paragrafi 2 dhe nenit 39 paragrafët 1 dhe 2 KPPK-së, i akuzuari dënohet me burgim prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj burgim, dhe me gjobë prej 400 € që duhet paguar brenda dy muajve.

Duke qenë se është gjetur fajtor sipas Pikës 3 për Krim të organizuar, bazuar në nenin 3 paragrafi 2 të KPK dhe nenit 274 paragrafi 2 dhe nenit 66 paragrafi 2, nenit 67 paragrafi 1 nën-paragrafi 2 të KPPK-së, i akuzuari dënohet me burgim prej 3 (tre) vite e 11 (njëmbëdhjetë) muaj burgim.

Duke u mbështetur në nenin 71, paragrafin 2 nën-paragrafi 2 të KPPPK-së, Gjykata shqipton dënimin unik me burgim prej (katër) 4 vitesh.

Duke u mbështetur në nenin 73 paragrafin 1 të KPPK-së dhe nenin 393 paragrafin 1, nën-paragrafin (5) të KPPPK-së, koha e kaluar në paraburgim prej 01 korriku 2011 deri me këtë date do tëllogaritet në këtë dënim burgu.

Duke u mbështetur në nenin 54 paragrafin 2 nën-paragrafin 7 dhe nenin 60 paragrafi 1 të KPPK-së, do të konfiskohet telefoni mobil Nokia, me ngjyrë të zezë, modeli 1280, që i përket S.T.t: me numër IMEI 355926/04/360261/1.

Duke u mbështetur në nenin 102, paragrafin 4 të KPPPK-së i akuzuari lirohet nga detyrimi për pagesën e shpenzimeve të procedurës që do të paguhen nga burimet buxhetore.

**ARSYETIM**

**Historiku procedural**

**Aktakuza**

Më 30 shtator 2011 Prokuroria Speciale e ka parashtruar Aktakuzën PP.nr. 138/09 kundër të akuzuarit S.T. për veprat penale në vijim, përkatësisht, dy pika të akuzës për Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, e kryer në bashkë-kryerje dhe në kundërshtim me nenin 229, paragrafët 1,2,3 dhe 4 në lidhje me nenin 23 të KPPK-së, dhe një pikë për Krim të organizuar në kundërshtim me nenin 274, paragrafët 1,2 dhe 3.

Më 21 dhjetor 2011 Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës e ka vërtetuar Aktakuzën e lartpërmendur nëpërmjet Aktvendimit KA.nr. 649/11

Gjatë seancës për vërtetimin e aktakuzës i akuzuari është deklaruar i pafajshëm.

**Kompetenca e Gjykatës dhe Përbërja e Kolegjit**

Të akuzuarit janë akuzuar për një vepër penale që dënohet me burgim prej së paku pesë vjet.

Në përputhje me nenin 23 (1) të KPPPK-së, Gjykatat e Qarkut do të kenë kompetencë për të gjykuar në shkallë të parë veprat penale të dënueshme me burgim prej së paku pesë vjet ose ato vepra të dënueshme me burgim afatgjatë.

Vepra penale, sipas Aktakuzës, është kryer në territorin e Republikës së Kosovës. Prandaj, në përputhje me nenin 27 (1) të KPPPK-së, kjo gjykatë ka juridiksion territorial për të gjykuar rastin.

Asnjë çështje nuk është ngritur nga palët lidhur me juridiksionin e kësaj Gjykate, dhe çështja e kompetencave të gjykatësit të EULEX-it për të kryesuar në këtë rast ishte e pakontestueshme.

Është për t'u theksuar se në bazë të nenit 3.1 të Ligjit mbi Kompetencën e Përzgjedhjes së Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (këtej e tutje "LiJ" ), Gjykatësit e EULEX-it të caktuar në procedurë penale kanë juridiksion dhe kompetencë për çfarëdo rasti të hetuar apo ndjekur penalisht nga Prokurorët Specialë të Republikës së Kosovës. Më 26 shkurt 2014 Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it vendosi që trupi gjykues në këtë rast duhet të përbëhet nga një Gjyqtar kryesues i EULEX-it, një anëtar paneli i EULEX-it dhe një Gjyqtar i Kosovës. Personi kontaktues i Gjykatës Themelore caktoi Mariola Pasnik si Kryetare të trupit gjykues. Aktvendimi është bazuar në nenin 3 të Ligjit mbi Kompetencën. Prandaj, trupi gjykues ishte i përbërë në mënyrë korrekte si një trup gjykues i përzier nga një gjyqtare e EULEX-it si kryetare dhe një gjyqtar i EULEX-it dhe një Gjyqtar vendor

si anëtarë të trupit gjykues.

**Shqyrtimi kryesor**

Shqyrtimi kryesor është mbajtur i hapur më 04 mars 2014, 11 mars 2014 dhe 12 mars 2014 në praninë e Prokurorit Special Charles Hardaway, të akuzuarit S.T. dhe avokatit të tij mbrojtës R.D..

Më 12 mars 2014, dhe me propozim të Prokurorit, është bërë një kërkesë që të tërhiqet pika e parë në aktakuzë nga neni 389, paragrafi 1 i KPPPK-së. Trupi gjykues e konsideroi këtë kërkesë dhe pas këshillimit e lejoi tërheqjen e Pikës një të aktakuzës. Në përputhje me këto rrethana, kjo pikë e aktakuzës hidhet poshtë në Aktgjykimin e mësipërm duke përdorur fuqinë dhënë Trupit Gjykues me nenin 389, paragrafi 1 i KPPPK-së.

Në përputhje me nenin 15 të KPPPK-së, përkthyesit ndërkombëtarë kanë përkthyer proceset dhe të gjitha dokumentet gjyqësore përkatëse të gjykimit nga anglishtja në anglishtja në shqip dhe anasjelltas, sipas nevojës.

**Përmbledhje dhe vlerësimi i provave të paraqitura**

Trupi gjykues i bazoi gjetjet e tij faktike në pjesët e mëposhtme të provave të cilat u konstatuan të jenë plotësisht të besueshme, domethënë akuzat faktike të përshkruara në aktakuzë kundër të pandehurit S.T., siç u ndryshuan me gojë, u provuan nga faktet e parashtruara në shkresat e lëndës.

(1) PËRGJIMI

1. Provat nga përgjimi janë të rëndësisë kritike. I pandehuri ka pranuar – duke pranuar në përgjigjen e tij gjatë marrjes në pyetje nga Kryetari i Trupit gjykues më 12 mars 2014 se referenca për “Su.”, “Sy.” ose “Sl.” i referohen atij. Kjo është e bazuar në faktin se këto referenca u zhvilluan në thirrjet telefonike të cilat ishin

në mënyrë të qartë pjesë e planifikimit dhe ekzekutimit të veprave penale të ngarkuara. I pandehuri me pranimin e tij ishte në kontakt fizik me njerëzit që kanë përdorur këto referenca. Nga dëshmitë e ekspertëve, ai ishte në mënyrë të qartë në kontakt telefonik me ta. Referencat u zhvilluan në kontekstin e këtij kontakti të rregullt. Nuk ka asnjë dëshmi të ndonjë tjetër "Su.", "Sy." ose "Sl." të përfshirë. Parashtrohet se i vetmi përfundim që mund të nxirret nga Gjykata është se këto referenca janë referencat e bëra të pandehurit.

(2) EKSPERTIZA E ZËRIT

2. Me kërkesën e Prokurorit është kryer një analizë për të bërë krahasimin e disa përgjimeve dhe zërin e S.T. siç është regjistruar gjatë deklaratave të tij në procedurën paraprake për të konkluduar nëse ato thirrje janë kryer nga S.T., një numër thirrjesh janë përputhur me S.T.-n, me konkluzionin nga fuqia e këtij krahasimi që sugjeron se ka pasur ngjashmëri tejet të mëdha ndërmjet zërave dhe nuk ka pasur ndonjë dallim të madh. Në fakt ekspertja nuk ka konkluduar se thirrjet tjera nuk janë bërë nga S.T. – ajo nuk ka pasur mundësi të vijë te një konkludim.

3. Në veçanti ekspertja ka qenë e mendimit se thirrjet telefonike në vijim kanë rënë në kategorinë e përputhjes me zërin e S.T.t:

27 korrik 2009 në ora 16:29:58
28 korrik 2009 në ora 12:46:12
28 korrik 2009 në ora 17:21:23
28 korrik 2009 në ora 21:58:26
28 korrik 2009 në ora 21:53:00
29 korrik 2009 në ora 19:36:06

(3) ANALIZA E EKSPERTIT TË TELEFONIT MOBIL

4. Pas analizës së telefonit mobil të të pandehurit, një telefon mobil NOKIA, e zezë, model 1280, me numrin IMEI: 355926/04/360261/1, Trupi gjykues vëren praninë e kontakteve me emrin “M.” “D.”, "Ximi "dhe" G.G. ". Gjykata është e vetëdijshme se personat e emëruar “M.”, “D.” dhe “X.” janë të referuar në materialin nga Shqipëria si pjesëmarrës në krime të rënda të kryera nga grupi i organizuar kriminal, veçanërisht në dërgesat e drogës së nëntorit 2009. Kjo siguron një pjesë shtesë të provave që lidhin të pandehurin me grupin.

(4) PROVAT E VËZHGIMIT

5. Trupi gjykues vëren përmbledhjen e Policisë së Kosovës të regjistrimeve të vëzhgimit për 15/16 shtator dhe 19 nëntor 2009 të cilat regjistrojnë takimet në mes Xh.T. dhe S.T.t në një restorant dhe një Parking, duke përfshirë ku shihen duke shkëmbyer një pako, siç janë filmuar në video dhe regjistruar në fotografi. Përveç raportit, takimi në mes të Xh.T.-t, S.T.t dhe G.G. në restorantin “Il.”ia në Vermicë më 16 shtator 2009 është regjistruar në video dhe në fotografitë e paraqitura në Gjykatën me shkresën e lëndës të shënuar "CD 2”.

6. Trupi gjykues po ashtu vëren raportin e Policisë shqiptare lidhur me regjistrimet e vëzhgimit për 26, 27, 28, 29 dhe 30.09.2009, REGJISTRATORI XXIV, i cili regjistron se me datën 29 shtator 2009, Xh.T. u takua me G.G. dhe të tjerët në Shqipëri. Fakti që ky takim u zhvillua paraqitet në raportin e vëzhgimit të Policisë Shqiptare që mbulon datat 26, 27, 28, 29 dhe 30 shtator 2009. Fotografitë e takimit të tyre më 29 shtator 2009 të paraqitura në këtë raport janë dorëzuar në Gjykatën me shkresën e lëndës të shënuar "CD 3”.

7. Le të përkujtojmë se në lidhje me ngjarjet e nëntorit 2009, në Deklaratën e tij në Prokurori të datës 6 dhjetor 2010, Xh.T. ka identifikuar veturën me targa regjistrimi 554-KS-161 që i përket atij (f.16). Pasi që u ballafaqua me fotografi të marra nga autoritetet e Shqipërisë, Xh.T. ka identifikuar G.G. dhe S.T. aty (f.16).

8. Sipas raportit të Policisë shqiptare lidhur me regjistrimet e vëzhgimit për datat 7, 8 dhe 9.10.2009, REGJISTRATORI XXIV, seksioni 3, faqe 1644 – 1653 ka pasur një takim tjetër mes Xh.T. dhe G.G., me fotografi të takimeve të tyre më 8 dhe 9 tetor 2009 dhe e dorëzuar në Gjykatë me shkresën e lëndës të shënuar "CD 3".

9. Trupi gjykues vëren në veçanti raportin e Policisë shqiptare lidhur me regjistrimet e vëzhgimit për datën 25.11.2009, NJN Regjistratori XXIV, faqe 1950-1952, i cili shënon se më 25 nëntor 2009, S.T. u takua me G.G. mes orës 10.00 dhe 10.35.

10. Më tej është e regjistruar që më vonë, më 25 nëntor 2009, Policia shqiptare ka vërejtur G.G., “M.”, “Il.” dhe tre persona të tjerë duke u takuar në qytetin shqiptar të Fierit, në hotel "Europa". Ata arritën në hotel në tre makina të veçanta: (i) një makinë BMW ngjyrë hiri me [tabela të regjistrimit], në të cilën ishin “M.” dhe G.G.; (ii) një Ford Mondeo ngjyrë të kaltër me një bagazh lëvizës me [tabela të regjistrimit], në të cilën ishte “Il.” me dy persona të moshës 25 -30 vjeç; dhe (iii) një Mercedes Benz ngjyrë hiri me [tabela të regjistrimit].

11. Pas takimit, ekipi vëzhgues ka parë “M.”-n duke u larguar me makinën BMW në drejtim të Fierit, ndërsa pesë personat e tjerë u largua drejt Tiranës në dy makina të tjera me [tabela të regjistrimit] dhe [tabela të regjistrimit]: G.G., “Il.”i dhe një tjetër person “Lu.” ishin në Ford Mondeo me [tabela të regjistrimit] dhe dy persona të tjerë, që dyshohet se janë G.T. dhe D.M. ose “Be.” [D.M.] nga Republika e Shqipërisë, ishin në Mercedes Benz me [tabela të regjistrimit]. Automjetet udhëtonin në një distancë prej 2-3 km midis tyre. Policia shqiptare ndaloi dy automjetet. Droga u gjet në automjetin në të cilin G.G. dhe “Il.” ishin duke udhëtuar. Automjeti i dytë ka shmangur pikën e kontrollit dhe të dy pasagjerët kanë braktisur makinën dhe u arratisën me sukses. Policia shqiptare ka gjetur disa pako që përmbanin substancë narkotike në Mercedes Benz të braktisur.

## A. <u>VËSHTRIMI I PROVAVE QË NDËRLIDHEN ME DËRGESËN E NËNTORIT 2009 – AKUZA 2</u>

12. S.T. është dënuar për një akuzë të kryerjes së veprës penale të Blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikeve në kundërshtim me nenin 229 të kodit Penal të Kosovës, në bashkëveprim, e lidhur me transportimin e nëntorit 2009.

13. S.T. gjithashtu duhet mbajtur përgjegjës për blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e narkotikeve mes 1 tetori 2009 dhe 25 nëntori 2009.

14. Lidhur me këtë, Prokurori ka prezantuar dëshmi se S.T. ka marrë pjesë në blerjen e një substance narkotike nga bashkëpunëtorët në Shqipëri, më saktësisht të 109 kilogramëve të *cannabis sativa* dhe e ka planifikuar transportimin e tyre nga Shqipëria në Kosovë, për shpërndarjen e planifikuar në Slloveni, Itali, Gjermani dhe/ose Holandë. Xh.T. gjithashtu e ka planifikuar dhe drejtuar transportimin, së bashku me anëtarët e tjerë të grupit kriminal në Shqipëri – veçmas me S.T-n dhe G.G. – dhe në Holandë, me A.T. dhe H.T.-n.

15. Droga është prerë dhe përgatitur nga ana e anëtarëve të grupit të organizuar në Shqipëri. Xh.T. dhe G.G. e kanë planifikuar dhe mbikëqyrur transportimin e drogave në Kosovë përmes korrierëve. Xh.T., G.G., A.T. dhe H.T. gjithashtu e kanë planifikuar shpërndarjen e mëtejme dhe shitjen e tyre.

16. 109 kg të *cannabis sativa* me sukses është zbuluar dhe konfiskuar nga ana e Policisë së Shqipërisë më 25 Nëntor 2009. Droga është gjetur në 102 pako në veturë me regjistrim TR75981, të braktisur nga ana e korrierëve në Shqipëri, kur është vërejtur ekipi i vëzhgimit i Policisë së Shqipërisë. Substanca nga secila pako është analizuar nga ana e Laboratorit të Forenzikës Kriminale të Shqipërisë, e cila kishte konfirmuar se ishte kanabis.

Planifikimi

17. Planifikimi i transportimit të dytë nga ana e Xh.T. për nëntor 2009 ka filluar në shtatorin e vonshëm 2009 dhe në tetorin e hershëm 2009, së bashku me H.T.-n dhe A.T.-in në Holandë dhe S.T.-n dhe G.G. në Shqipëri.

18. Më 29 shtator 2009, Xh.T. u takua me G.G. në Shqipëri. Fakti se ky takim është mbajtur provohet nga raporti i vëzhgimit i Policisë së Shqipërisë, që i mbulon datat 26, 27, 28, 29 dhe 30 shator 2009. Fotografitë nga takimi i tyre i 29 shtatorit 2009 i cili ceket në këtë raport, i janë treguar Gjykatës.

19. Më pastaj, hapi i parë është dëshmuar me thirrjen e incizuar mes Xh.T. dhe H.T.-t më 4 tetor 2009, gjatë së cilës H.T. e njofton këtë se ai siguronte paratë e nevojshme për blerjen e drogës së re dhe për ti paguar korrierët.[1] S.T. përmendet veçanërisht si i përfshirë në këtë punë.

20. Pas pak kohe, Xh.T. bën plane për të shkuar në Shqipëri për të bërë marrëveshje me G.G. për dërgesën e radhës.[2]

21. Fakti që ky takim është mbajtur është vërtetuar nga raporti i vëzhgimit i Policisë Shqiptare për periudhën 7, 8 dhe 9 Tetor 2009. Fotografit e takimeve të tyre me datë 8 dhe 9 Tetor 2009 të siguruara në këtë raport i janë prezantuar Gjykatës.

22. Pesë ditë më vonë, Xh.T. ka thirrur A.T.-in në [tel. nr.] në Holandë për të diskutuar kushtet e marrëveshjes së re me Shqiptarët.[3] Këtu Xh.T. përgjigjet duke

---

[1] Regjistratori i Përgjimit VIII, 04/10/2009 në orën 16:54:54, (faqet 217-218). H.T.-u Xh.T.: "Daja Sy." (S.T.) erdhi në Gjermani... me veturë, andaj A.T. po i përgatit ca nga paratë e mia për t'ia quar "G." [G.G.]" dhe "një mik i imi shumë i fort ka ardhur nga Zvicra, një djalë shumë i mirë me para ka arritur".

[2] Regjistratori XI i përgjimeve, 07/10/2009, 15:51:10, (f.220-223, 222) H.T.-u Xh.T.: "ai i yti më tha, ai më tha që po shkon te "G." [G.G.], nëse aranzhon diçka, por... mos guxo me ndërmarrë diçka pa mua"

pohuar në pyetjen e A.T.-it nëse blerësi  ka blerë “500m$^2$”. Xh.T. i thotë A.T.-it se ai vetë kishte qenë në Shqipëri dhe “direkt me shefin” Xh.T. i thotë A.T.-it se e dëshiron “Be.” (nofka e B.T.) në Shqipëri për të vlerësuar “parcelën” (që nënkupton për të testuar kualitetin e narkotikëve) dhe e pyet Xh.T. që të shkoj pastaj dhe të bëjë marrëveshjen. Xh.T. i thotë atij se ata që të dytë tashmë kishin qenë për të parë “parcelën” që më vonë i referohet si “gjithë ato vetura”. Kjo është gjuhë e shifruar për paketimet e drogave.

23. Me 12 Tetor 2009, ora 13:17:00, Xh.T. bisedon me A.T.-in i cili përdor numrin e telefonit [Tel. nr.]. Xh.T. i thotë A.T.-it që “një shok po vjen sonte për darkë te unë, a e  din vëllai i kujt është, ai është vëllai i më të madhit, sot do të vjen tek unë dhe do të më tregojë gjithçka në detaje për këta personat që më ke pyetur”. A.T.-i thotë “mirë” dhe pyet nëse ka ardhur “Su.”. Xh.T. i përgjigjet që “Unë kam qenë në Shqipëri dhe nuk kam thirr më pas kësaj”. A.T.-i i thotë “Kam shpresuar që t marrë disa para por ende nuk i kanë sjellë dhe janë vonuar, krejt çka kap pasur është dashur ti dërgoj dhe gjitha paratë që ai i ka shti për ti ju ndihmuar pak”. Xh.T. i thotë “ok në rregull po çka po thonë ata persona?” A.T.-i i thotë “Nuk po thonë asgjë janë mbushur me ta, i kamë thanë që së paku ti mbajnë të hapur telefonat e tyre, i kamë këtu edhe 3 apo 4 persona tjerë që po kërkojnë por nuk po guxoj të bashkëpunoj me ta, a po më kupton”.

24. Një marrëveshje qartazi është arritur, siç vërtetohet me thirrjen e Xh.T. për L.K., vëllain e A.K., me 28 Tetor 2009 ku ai i kërkon L.K.-it që ti dërgojë “10,000 Euro dhe duhesh të mi dërgosh këtu në Kosovë këtë javë sepse do të forcohemi .... po flasim për disa vetura të mira”[4]. Kjo më tej përkrahet me thirrjen e Xh.T. të një bashkëpunëtori të quajtur “Gr.” në Gjilan me 2 Nëntor 2009 në të cilën i thotë atij “për 10 ditë do ta japë një infuzion të madh, mbaje në mend do ta jap një të madhe që kurrë nuk do ta harrosh”.[5]

---

[3] Regjistratori i Përgjimeve, 12/10/2009 ora 13:21:48 (f.224-229)
[4] Regjistratori i Përgjimeve, X, 28/10/2009 ora 16:10:51 (f.2289)

25. Në të njëjtën kohë, H.T. ka bërë marrëveshje në emër të grupit me një blerës nga Peja i cili kishte premtuar "para të gatshme ... për 150 copë të asaj, e dinë për çfarë copë po mendoj....".[6]

26. Me 16 Nëntor 2009, G.G. ka dërguar SMS një personi të panjohur dhe e pyet atë "ku është "Baca Sl." [S.T.]?"[7]

27. Provat nga përgjimet e siguruar nga Policia shqiptare të cilët kanë përgjuar telefonin e G.G.-ës tregojnë që me 18 Nëntor 2009, G.G. është udhëzuar që të finalizojë marrëveshjen[8]. Këtu metrat e referohen sasisë së drogës.

28. Me 19 Nëntor 2009, Xh.T. është takuar me G.G. për të bërë aranzhime të mëtutjeshme lidhur me transportimin nga Shqipëria.[9]

29. Kjo është e mbështetur nga raporti i Policisë së Kosovës- Ekipi Vëzhgues i datës 19 Nëntor 2011.[10] Fotografitë 2-12 paraqesin G.G. duke u takuar me B.B. afër një shitoreje në Prizren. Siç është cekur nga dëshmitari "Ga.", Xh.T. nuk mund të shihet në fotografi por është parë nga ekipi vëzhgues duke u takuar me G.G.-in më pastaj, siç është shënuar në raporte.

30. Me 19.11.2009, sipas vëzhgimit në ora 14:44 tek dalja e Prizrenit, në drejtim të Brezovicës, G.G. në veturën e tij Range Roverin me [tabela të regjistrimit], është takuar me XH.T.-n i cili po ngiste një veturë Gof V me [tabela të regjistrimit]. Pastaj ata kanë vazhduar në drejtim të Prevallës, dhe në ora 14:58 kanë shkuar te Restorant "Malboro", nga Restorant "Malboro" dy të dyshuarit kanë shkuar tek restoranti "Vila Park". Në ora 16:51 në të njëjtën datë, Xh.T. dhe G.G.-i kanë

---

[5] Regjistratori i Përgjimeve, X, 02/11/2009 ora 19:02:32 (f.2299)
[6] Regjistratori i Përgjimeve, XI, 12/11/2009 ora 19:16:50 (f.251-252)
[7] Materiali i përgjuar në Shqipëri, 16/11/2009 ora 19:56:01
[8] 18/11/2009 ora 10:26:12 – "Shok, bisedova me atë shokun i cili është komandanti, kjo marrëveshje do të bëhet, 100 deri në 150 metra katrorë".
[9] Regjistratori i Përgjimeve X, 18/11/2009 ora 22:46:34 (f.2385) "a ka mbërri "G."?"); dhe Regjistratori i Përgjimeve XI, 19/11/2009 ora 14:30:04, (f.256-257) "tash do të vij".
[10] Regjistratori i Policisë VII, f.2586-2588) fotografitë përcjellëse.

shkuar në shtëpinë e Q.T.-it në Prevallë. Shtëpia është afër një restoranti të drurit. Të dyshuarit në fjalë kanë hyrë në atë shtëpi. Afër asaj shtëpie ka qenë edhe një veturë Golf VI me [tabela të regjistrimit] dhe një Mercedes me [tabela të regjistrimit], dhe kanë qëndruar deri ora 17:24 dhe pastaj gjitha veturat e përmendura kanë vazhduar për në Prizren ku janë parkuar tek restorant "Dora" i cili është i Xh.T. Kanë qëndruar në këtë restorant deri ora 20:15 dhe pastaj kanë shkuar tek Qendra Tregtare "ETC" në Prizren. Janë takuar me shoferin e BMW përsëri dhe kanë qëndruar së bashku deri ora 20:45. Pastaj G.G.-i ka vazhduar në drejtim të kufirit në Vermicë.

31. Prandaj, provat e marra nga përgjimet e Policisë shqiptare tregojnë që Xh.T. ka kërkuar nga G.G. që të organizoj korrierin për transportimin e dërgesës së re nga Shqipëria në Kosovë.[11]

32. Pagesa për marrëveshje është siguruar nga H.T., i cili ka thirrur XH.T.-n me 21 Nëntor 2009 për ta informuar që "ditën e hënë ai do të marrë 110,000 Euro për ti dërguar G.G.-it për mallin e tyre".[12] Po të njëjtën ditë, H.T. informon Xh.T. që ai tashmë kishte pranuar 62,200 nga blerësit në Holandë.[13] Këto para kanë ardhur nga "K.".

33. Ekzistojnë prova që disa nga blerësit ka qenë nga Italia. Përkatësisht me 21 Nëntor 2009, A.T.-i ka thirre Xh.T. nga Holanda për të marrë informatë nëse korrierët nga Italia do të shkonin javën tjetër –"ndoshta javën tjetër do të vijnë...e din për punën në ujë... ti the dikush do të vij dhe do ta marrë, a po më kupton?" Këtu "ujë" është përsëri është shifër për Italinë.[14] Kjo bisedë është gjithashtu provë që biznesi i Xh.T. me S.T., siç deklaron A.T.-i "ky personi që ka qenë tek ti, ky "Su." [S.T.], sa është e tij "toka", deri në 300 metra katrorë? Deri 600 metra

---

[11] 20/11/2009 ora 13:00 dhe 13:31:09 – siguroje një "gomar" për "biznesin tonë" për një çmim prej"15-20 mijë"

[12] Regjistratori i Përgjimeve XI, 21/11/2009 ora 12:46:37 (f.263-264)

[13] Regjistratori i Përgjimeve XI, 21/11/2009 ora 13:09:36 (f.265-266)

[14] Regjistratori i Përgjimeve XI, 21/11/2009 ora 13:14:41 (f.268-273, 271)

katrorë pa problem ... javën tjetër një peron do të vij...” (f.272). Këtu toka është shifër për drogën me metrat katrorë për sasinë.

34. Pretendimet për një dërgesë të planifikuar gjithashtu mbështeten nga një tjetër thirrje telefonike mes Xh.T. dhe H.T.-t po të njëjtën ditë në të cilën diskutojnë shqetësime lidhure me kualitetin e drogës që vjen nga Shqipëria dhe përfshirjen e mëhershme të S.T.t:

A.T.: Ti ke qenë këtu kur daja “Sl.” [S.T.] ka ardhur me atë objektin e fëlliqtë nuk duhet të jetë si ai i fëlliqmi...

Xh.T.: mos u brengos për atë punë hiqe

A.T.: “vendi” duhet të jetë i pastër... kanë mundur të lënë gati 50% për ju.

Xh.T.: Mos u brengos.

A.T.-i: Ai bërllok duhet të jetë i pastër... përndryshe thuaju që do të presim... do të presim deri të pastrohet, a po më kupton”.[15]

35. Ekzistojnë prova të përgjimeve shtesë ku H.T. dhe Xh.T. diskutojnë ndarjen e fitimeve si dhe sasinë dhe paketimin e dërgesës:

A.T.: një e treta (1/3) do të merret prej ne nga ai dhe dy të tretat (2/3) do të jetë në posedimin tonë.

...Unë isha me H.T.-n, bisedova me “Dajën” [S.T.] edhe dje; 2000 qysh kanë qenë por edhe ne është dashur të paguajmë 300 deri atje, a po më kupton?

... I thashë G.G.-it 1/3 do të merret nga ata, neve do të na paguhen 2000, dhe prej 2000 ne duhet të paguajmë 300 për biletën, a po më kupton? (nënkupton 300 për korrierin)

Xh.T.: Po

---

A.T.: A të kujtohet që kemi tentuar që të bëjmë “marifetet” tona jo 60 por 65 ...çka kam pasur i kam pasur bashkë me H.T.-n dhe i kemi pasur ato në prezencën tënde...

[15] Regjistratori i Përgjimeve XI, 21/11/2009 ora 13:26:03 (f.274-277, 276)

....Më kanë munguar, por i kemi thanë që në fillim, çështjet e paketimit dhe gjëra tjera, a po më kupton?

Xh.T.: përfundoje këtë bisedë[16]

36. Provat e marra nga përgjimet nga Policia Shqiptare të cilët kanë përgjuar telefonin e G.G.-ës tregojnë që G.G.-i ka mbikëqyrur procesin e prerjes dhe përgatitjes së drogës për dërgesë të re. Më rënduese janë përgjimet e theksuara në Raportin e Zyrës së Prokurorisë së lartë për Krime të Rënda të Republikës së Shqipërisë të titulluara “sekuestrimi i 109 kg kanabis sativa me datë 25.11.2009.

37. Me 24 Nëntor 2009 ora 06:00:08, G.G. ka dërguar një SMS një bashkëpunëtori me G.G. Gjikës duke e udhëzuar atë që të “përgatisë edhe 10 të tjera”.

38. Me 24 Nëntor 2009 ora 08:36:36, G.G. ka dërguar një SMS bashkëpunëtorit me [tel. nr.] duke i thënë “nesër në mëngjes do të aterojmë” që nënkupton se dërgesa për në Kosovë është caktuar për 25 nëntor 2009.

39. Me 25 Nëntor 2009 ora 09:07:53, G.G. ka dërguar një SMS bashkëpunëtorit me [tel. nr.] duke e pyetur “Qysh e ke përgatitur?”? duke i ju referuar presimit të substancave narkotike. Kjo pason me një tjetër mesazh në ora 09:09:56 për bashkëpunëtorin e njëjtë për të shikuar nëse i kanë presuar narkotikët me kompresor apo me dorë, duke i thënë “me “va apo me dorë?”. Bashkëpunëtori i përgjigjet ora 09:10:34, dhe i thotë G.G.-it që “e kam bërë me dorë”, që nënkupton se e ka presuar drogën me dorë.

40. Kjo mbështetet nga analiza ekspertizë që tregon se droga është paketuar në mënyrë manuale.

41. Provat nga përgjimet e marra në Shqipëri, të mbështetura nga provat prej vëzhgimit të kryer nga Policia e Shqipërisë në vend të ngjarjes, zbulojnë ngjarjet e

[16] Regjistratori i Përgjimeve XI, 23/11/2009 ora 19:26:50 (f.281-283)

25 Nëntorit 2009 në të cilat anëtarët e grupit në Shqipëri kanë tentuar të transportojnë 109kg cannabis në Kosovë sipas marrëveshjes mes Xh.T., H.T.-t, A.T.-it, S.T.t dhe G.G.-ës. Policia Shqiptare kanë përgjuar telefonin e G.G.-ës dhe kanë pasur nën vëzhgim G.G. dhe "M."-n. Ata kanë mundur të vëzhgojnë takimet e Xh.T. me ta si dhe thirrjet që u ka bërë atyre.

42. Provat më relevante nga përgjimet prapë janë të theksuara në Raportin e Zyrës së Prokurorisë së Lartë për Krime të Rënda të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu referoj Gjykatën në Raportin e Policisë së Kosovës të datës 01.03.2010 të titulluar "Raport lidhur me transkriptat e përgjimeve nga CD prej Shqipërisë 17.11.2009".[17]

**25.11.2009 ora 08:59:02**

"M." në [Tel. nr.] ka thirrur G.G. për të pyetur atë nëse kishte filluar. G.G.-i i thotë që tani do të "filloj" "M." i thotë që të mos vonohet. "M." dhe "Il." kanë qenë në Gjirokastër.

**25.11.2009 ora 09:46:22**

Korab, djali i S.T.T duke përdorë [tel. nr.] dërgon një SMS G.G.-ës si në vijim: "sa kohë i duhet për me ardhur?"

**25.11.2009 ora 10:58:51**

Personi në për"Do."m të [tel. nr.] thërret G.G. dhe e pyet çfarë po ndodhë. G.G.-i i thotë "Jam rrugës për tek ti".

**25.11.2009 në ora 13:47:22**

G.G. e thirr personin duke përdorur numrin e telefonit [tel. nr.] dhe e pyeti se ku ishte ai. Personi u përgjigj "Unë jam këtu afër ujit duke ardhur te vetura, a je duke ardhur këtu?'' G.G.-i tha: "Jam duke ardhur". Personi u përgjigj "Unë vij te vendi para para se të shkon ti te ura, para se të arrin ujin e ftohtë, në anën e djathtë të

[17] Regjistratori i Policisë V, seksioni 10

veturave te Luzati”.

**25.11.2009 në ora 13:57:35**

G.G. e thirr personin duke përdorur [tel. nr.] prapë për ta pyetur se ku ishte. Personi u përgjigj se ishte “te uji”. G.G.-i e pyeti nëse ishte ndalur ai te uji. Personi u përgjigj se ai “ishte duke iu afruar ujit të ftohtë. Ne nuk jemi me veturë, ne jemi me kombi te Luzati ku është një tabelë e shkruar në anën e djathtë dhe aty është një auto servis dhe ti ndalu aty për të më marr mua” G.G.-i tha: “Nuk dua të vij pasi që do të ndalem në Tepelenë dhe ti duhesh të vjen për të më marr mua’’.

**25.11.2009 në ora 18:31:35**

Personi i cili e për”Do.” [tel. nr.] e thirri G.G.. G.G.-i tha se ai ishte “bashkë me atë shokun” duke iu referuar “M.”-it. Personi pyeti nëse ishin “lart apo poshtë”. G.G.-i tha se ishte “duke u afruar”. Në të njëjtën kohë, “M.” foli me një person tjetër duke e përdorur [tel. nr.] i cili i tha se ishte në Pejë.

**25.11.2009 në ora 20.57.42**

G.G. e thirri [tel. nr.]. Personi tha: “ne jemi larg prej veturës” G.G.-i u përgjigj “afrohu dhe shiko”. Më vonë, G.G.-i tha “eja, jam duke kaluar aty pari”. Përdoruesi i [tel. nr.] dyshohet të jetë njëri nga dy personat të cilët e transportonin drogën në veturë më pas të gjetur nga policia e Shqipërisë.

43. Kjo sekuencë e ngjarjeve është konfirmuar nga raporti i ekipit të vëzhgimit të policisë shqiptare[18] e cila më 25 nëntor 2009 e vrojtoi G.G., “M.”-in” “Il.-in” dhe tre persona të tjerë duke e takuar në qytetin shqiptar të Fierit, në hotel “Europa”. Ata arritën në hotel në tri vetura të ndara: (i) një veturë ngjyrë hiri BMW me [tabela të regjistrimit] me të cilën arritën “M.” dhe G.G.; (ii) një Ford Mondeo ngjyrë të kaltër me bagazh portativ (mbartshëm) me [tabela të regjistrimit] me të cilin arriti “Il.”-i me dy persona të tjerë të moshës 25-30 vjeçare; dhe (iii) një Mercedes Benz ngjyrë hiri me [tabela të regjistrimit].

[18] Dosja NJN XXIV, fq.1950-1952

44. Pas takimit ekipi vëzhgues ka parë “M.”-n duke u nisur me BMW në drejtim të Fierit, gjersa pesë personat e tjerë u nisën drejtë Tiranës me dy vetura të tjera me [tabela të regjistrimit] dhe [tabela të regjistrimit]: G.G., “Il.” dhe personi tjetër “Lu.” ishin në Ford Mondeo me [tabela të regjistrimit] dhe dy persona të tjerë që dyshohet të jenë G.T. dhe D.M. (ose “Be.”) nga Republika e Shqipërisë ishin në Mercedes Benz me [tabela të regjistrimit]. Automjetet kishin një distancë prej 2-3 km midis tyre. Policia shqiptare i ndali dy veturat. Nuk është gjetur drogë në veturën me të cilën udhëtonte G.G. dhe “Il.”. Vetura e dytë iu shmang pikës së kontrollit dhe dy udhëtarët e lanë veturën dhe ikën suksesshëm. Policia shqiptare gjeti disa pako me substancë në veturën e lënë Mercedes Benz.[19]

45. Raportet e ekzaminimit të forenzikës nga Laboratori i Kriminalistikës në Shqipëri, të datës 8 dhjetor 2009, 21 qershor 2010 dhe 6 korrik 2010 dëshmojnë se substanca e konfiskuar ishte në fakt 109 kg. Kanabis sativa[20].

46. Transportimi i kanabisit ishte në rrugë për Kosovë si rezultat i marrëveshjeve të bëra nga grupi kriminal i organizuar.

<u>Përfundim</u>

47. Është e qartë nga dëshmia se transportimi i drogave narkotike është blerë dhe shpërndarë në nëntor 2009 nga një grup i organizuar kriminal. Është e qartë se transportimi ka qenë për 109 kg të kanabisit. Është gjithashtu e qartë se i pandehuri ishte i përfshirë në këtë krim të rëndë.

---

[19] Procesverbali i inspektimit të veturës Mercedes Benz [tabela të regjistrimit], Dosja e NJN XXIV fq.1975-1980; dhe Raporti mbi konfiskimin e gjësendeve nga Policia Shqiptare, fq.1981-1982

[20] Dosja NJN XXIV, seksioni 6, fq.1992-1997

## B. VËSHTRIM I PROVAVE TË MËTEJME QË MBËSHTESIN VEPRËN PENALE KRIMI I ORGANIZUAR - AKUZA 2

48. I pandehuri në këtë rast është dënuar për një akuzë të krimit të organizuar.

49. Prokuroria ka provuar ekzistimin e grupit të strukturuar e mbi 3 personave i cili ka ekzistuar prej së paku nga viti 2009 deri më tani dhe vepron në marrëveshje të përbashkët për të kryer krime të drogës për përfitime materiale të tyre dhe të tjerëve.

50. Dëshmia e përmendur më herët në lidhje me planifikimin e bartjes së drogës si dhe bartja e shtatorit dhe nëntorit të vitit 2009 gjithashtu qëndron si provë e krimit të organizuar.

### (i) Struktura e grupit: lidhjet ndërkufitare

51. S.T. është anëtar i këtij grupi kriminal, i cili përbëhet nga Xh.T., A.K., G.G., G.I., H.T., A.T. dhe të tjerët. Ai ishte i përfshirë, siç përshkruhet më sipër, në blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e substancave narkotike. Ai ishte në kontakt të rregullt me anëtarët e grupit në Kosovë, Shqipëri dhe Holandë.

52. Xh.T. e ka rolin kyç në koordinimin e zbatimit të aktiviteteve të këtij grupi kriminal. Ai shpesh komunikon ose i takon bashkëvepruesit e shumtë në Kosovë (A.K., ‘’Bes.’’, “Ku.’’, B.B., ‘’Sh.’’, ”Gr.”’ dhe B.T.) në Shqipëri (G.G., S.T. dhe ‘’M.”) në Holandë (H.T., ‘’A.T.-i’’ dhe Z.T.), Gjermani, Itali dhe Zvicër (“Ad.” dhe të tjerët).

53. A.K. vepron kryesisht me Xh.T.-n dhe sipas urdhrave të Xh.T. Sa i përket transportimit të shtatorit roli i A.K.-it ishte të rregullojë dhe mbikëqyr korrierin i cili e transportonte drogën në Zvicër. Xh.T. kishte kontroll të gjithmbarshëm

mbikëqyrës në operacion. A.K. dhe Xh.T. e kontaktonin njëri tjetrin çdo ditë në telefon dhe gjithashtu takoheshin rregullisht.

54. G.I. është gjithashtu anëtar i grupit i përfshirë në transportim, dorëzim dhe shpërndarje të substancave narkotike me qëllim që ato të shpërndahen, shiten ose ofrohen për shitje. G.I. punon për anëtarët e grupit në Shqipëri dhe roli i tij është të veproj si korier i drogës prej Shqipërisë në Kosovë.

(ii) <u>Modalitetet e kryerjes së veprës së trafikimit të drogës</u>

55. Grupi kriminel përdor automjete duke përfshirë vetura, autobusë dhe kamionë për të kryer vepër penale të trafikimit të drogës. Çdo transportimi i drogës është i mbështjellë në paketime në një pjesë të fshehur të automjetit (kamionëve) ose në rezervuarin e karburantit ose nën ulëset e prapme të veturave.

56. Kjo mund të shihet nga mënyra në të cilën grupi e bëri transportin e nëntorit 2009. Domethënë, 109 kg të kanabis sativa ishte gjetur nga policia shqiptare në një pjesë të Mercedes Benz-it të braktisur me [tabela të regjistrimit] në 102 pako. Ky transportim ishte në rrugë për te Xh.T. në Kosovë.

(iii) <u>Përfitimi material</u>

57. Dëshmia para gjykatës padyshim tregon se përfitimet materiale dhe financiare janë bërë nga anëtarët e grupit kriminal, duke përfshirë Xh.T.-in dhe A.K.-in dhe anëtarët e tjerë në Kosovë, Holandë dhe Zvicër si dhe S.T. dhe G.G. në Shqipëri.

58. Së pari, bisedat e shumta midis anëtarëve të grupit të organizuar të cilët janë përgjuar ligjshëm nga policia e Kosovës dhe autoritetet e Republikës së Shqipërisë përbëhet nga diskutimet në lidhje me blerjen e narkotikëve dhe

përfitimin. Për shembull, më 29 dhjetor 2009, Xh.T. e informoi kolegun e tij se ai tani e kishte blerë tërësisht restorantin e tij.[21]

59. Ngjashëm, në rrjedhën e menjëhershme të transportimit të shtatorit 2009, H.T. i tregoi Xh.T. se atij iu kishte dhënë apo blerë një apartament i madh në Francë. Është e qartë se ky apartament ishte shpërblim për bartjen e mëparshme të drogës dhe shitjeve pasi që ata vazhduan të diskutojnë dërgesat e ardhme:

H.T.:... të hënën ai do të dërgojë dy dërgesa për 400 copë të veta.

Xh.T.: E di, mos fol.

H.T.: Çdo gjë është duke shkuar sipas planit...

…

Xh.T.: Nesër do të jem në atë anë por thirrëm me IPKO, mos më thirr në këtë numër'[22]

60. Tani është me rëndësi të kujtojmë bisedat ku H.T. i tha Xh.T. se përfitimi i tyre nga transportimi i shtatorit 2009 ishte 86,000 euro.[23]

61. Me 24 tetor 2009 Xh.T. i tha një bashkëpunëtori tjetër se "kishte blerë tokë në Prizren për 80.000 euro"[24]. Kjo tokë qartazi është blerë duke shfrytëzuar të hollat e fituara nga shpërndarja e drogës.

62. Lidhur me dërgesën e muajit nëntor 2009, Policia e Shqipërisë përgjoj në mënyrë ligjore bisedat financiare në mes të G.G.-ës në Shqipëri me H.T.-in dhe A.T.-in në Holandë dhe Xh.T.-in në Kosovë. Për shembull, me 18 nëntor 2009, G.G. morri një mesazh SMS nga një bashkëpunëtor i panjohur lidhur me bartjen e narkotikeve nga Shqipëria në Kosovë që pyeste "G.G., kur do të kalosh? Ai ke 2900 Euro? Më nevojiten për "fituesit". Në këtë mesazh, "fituesit" është fjala e

---

21 Regjistratori i përgjimeve VIII, 29/12/2009 në ora 17:58:10, f. 2010

22 Regjistratori i përgjimeve VIII, 18/09/2009 në ora 23:30:19, f. 2024

23 Regjistratori i përgjimeve VIII, 13/09/2009 në ora 14:01:06, f. 1976-1977

24 Regjistratori i përgjimit IX, 24/102009 në ora 18:43:19, f.2203

koduar e përdorur për të shpjeguar narkotikët. Përsëri, në ora 13:00:08 me 19 nëntor 2010, G.G. e pyet Xh.T.-in për ta kryer një punë për te lidhur me një “gomar” për “15 ose 20 mijë”. Siç u përmend më lartë, “gomari” është kodi për kamionin ose korrierin që bartte drogën. Xh.T. e organizoi bartjen e dërgesës përkatëse në nëntor të 2009-tës. Unë ia referoi Gjykatës Raportin e Policisë së Kosovës të datës 01.03.2010 të titulluar “Raporti për transkriptimet e përgjimit nga CD-të nga Shqipëria 17.11.2009 deri me 25.11.2009.”

63. Më tej, Prokurori mbështetet në Raportin e Ekspertit të Sektorit për Hetime Financiare të Kosovës, Departamenti kundër Krimit të Organizuar, i datës 17 dhjetor 2010. Informatat e pranuara ilustrojnë një numër të transaksioneve të dyshimta që është parashtruar se përfshijnë deponimin dhe transferimin e të ardhurave të furnizimit dhe shpërndarjes se narkotikëve gjatë periudhave kohore relevante.

A.K.

64. Gjatë bastisje së shtëpisë së A.K.-it në [fshatin K.] me 27 maj 2010, Policia gjeti dhe konfiskoi trembëdhjetë mijë (13,000) Euro që për”Be.”n njëzet e gjashtë (26) monedha secila në vlerë prej peseqind (500) Euro. Këto para mund të shpjegohen në mënyrë të besueshme vetëm si fitim nga shpërndarja e drogës për grupin. Ky pohim mbështetet me provat e përgjimit.

S.T.

65. Si është parë nga përgjimi i 15 gushtit 2009 në ora 16:07:35, dhe konfirmuar me dëshminë e K.G-it,[25] S.T. morri shumën prej 4500 Euro nga H.T. dhe A.T.. Prandaj ai pranoi përfitim material.

[25] Procesverbali i shqyrtimit kryesor, 23 janar 2013, f 13

Përfundim

66. Është e qartë se ishte një grup i organizuar kriminal që vepronte ndërmjet datës 24 Korrik 2009 dhe 25 Nëntor 2009, i cili ka kryer një krim serioz, respektivisht blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm. Më tej, është e qartë që anëtarët e grupit janë Xh.T., A.K., G.G., G.I., A.T. dhe H.T. Të pandehurit ishin pjesëmarrës aktiv në këtë grup. Ky konkluzion është bazuar nga provat në tërësi, dhe në veçanti nga provat që ai ishte në kontakt të vazhdueshëm me anëtarët e tjerë, duke diskutuar dërgesën e drogës dhe pagesat për këto dërgesa. Gjithashtu, për t'u marrë parasysh janë dhe provat e vëzhgimit, që tregojnë se ai kishte takime me këto anëtarë të tjerë të grupit kriminal.

**PËRSHKRIMI I AKTGJYKIMIT i datës 18 mars 2013 kundër A.K.-T and Xh.T.**

67. Në Aktgjykimin e marrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës në rastin PPkr 22/13 kundër A.K.-t dhe Xh.T.-t më 18 mars 2013, trupi gjykues (me Gjyqtarin e EULEX-it Dean PINELES si kryetar të trupit gjykues) e shpalli të pandehurin A.K. fajtor për blerjen, posedimin shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm në shkelje të nenit 229, paragrafët 2 dhe 4, nën-paragrafi 1 KPPK-së dhe të Xh.T. fajtor për blerjen, posedimin shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm në shkelje të nenit 229, paragrafët 2 dhe 4, nën-paragrafi 1 KPPK-së, dhe fajtor për një akuzë të krimit të organizuar në shkelje të nenit 274, paragrafi 2 të KPPK-së.

68. Ai rast doli nga faktet të cilat do të merren parasysh në këtë rast. Në çështjen PPkr 22/13 të pandehurit e përmendur më lart pranuan fajësinë bazuar në aktakuzat e ndryshuara në të cilat, sikurse në rastin e z. S.T., ndaj dy të pandehurve ishte tërhequr një pikë sipas nenit 389, paragrafi 1 të KPPPK-së. Në rastin 22/13 i pandehuri A.K. u dënua me tri (3) vjet burgimi dhe i pandehuri Xh.T. u dënua me një dënim unik prej pesë (5) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgimi.

**Përcaktimi i Dënimit**

Gjatë përcaktimit të dënimit për secilin nga të akuzuarit, Gjykata ishte e detyruar që të vlerësoj të gjithë faktorët, sipas nenit 64 paragrafi (1) i KPPK-së.

Sipas nenit 66 paragraf 2 i KPPK-së, si faktorë lehtësues, trupi gjykues ka marrë në konsideratë:

Pranimin e fajësisë të ofruar nga i akuzuari;

Mosha dhe gjendja shëndetësore jo e mirë e të akuzuarit;

Fakti që i akuzuari nuk ka dënime të mëparshme.

Ishte detyrë e Gjykatës që të llogariste periudhën kohore që i akuzuari ka kaluar në paraburgim, për sa i përket burgimit që ishte caktuar atyre.

Gjykata ka konsideruar, duke marrë parasysh faktorët në këtë rast se një dënim me burg prej dy vjet dhe gjashtë muajsh, duhet të caktohet në lidhje me pikat e ngelura që kanë të bëjnë me narkotikët në aktakuzë, në pajtim me nenin 38, paragrafët 1 dhe 2 i KPPK-së.

neni 229, paragrafi 4 përcakton një periudhë kohore burgimi nga tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet. Ky dënim mund të zbutet në përputhje me nenin 66, paragrafi 2 i KPPK-së, dhe në veçanti sipas dispozitave të nenit 67, paragrafi 1, nën-paragrafi 2 të cilët i referohen mundësisë së zbutjes deri në një vit, nëse vepra parasheh një dënim prej së paku tre vjet; në këtë rast, trupi gjykues, duke dhënë atë që beson të jetë pesha e përshtatshme për të gjithë faktorët relevant, ka vendosur dënimin e treguar më lartë.

Trupi gjykues gjithashtu thekson se neni 229, paragrafi 4 thotë se "*kryerësi duhet të dënohet me gjobë...",* dhe si rezultat, në pajtim me dispozitat e nenit 38, paragrafët 1 dhe

2, trupi gjykues cakton një gjobë prej 400 €, dhe i jep të pandehurit dy (2) muaj kohë për të paguar gjobën.

Më tej, Gjykata ka konsideruar, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, se një periudhë burgimi prej tre (3) vjet e njëmbëdhjetë (11) muaj duhet të shqiptohet për pikën e krimit të organizuar në aktakuzë, sipas dispozitave të nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 i KPPK-së.

Në llogaritjen e dënimit, trupi gjykues vendosi që të marrë në konsideratë rregullat mbi aplikimin e zbutjes së dënimit në pajtim me neni 66 paragrafi 2 i KPPK-së, veçanërisht, një dënim mundë të shqiptohet nën kufirin që përcaktohet nga neni 274 paragrafi 2, që thotë se vepra duhet të dënohet me të paktën pesë vjet burgimi. Gjykata gjithashtu nënvizon në veçanti dispozitat e nenit 67, paragrafi 1, nën-paragrafi 2, të cilët i referohen mundësisë së zbutjes së dënimit me një vit burg, nëse vepra parasheh një dënim prej së paku tre vjet.

Prandaj, trupi gjykues është i detyruar të marrë në konsideratë dispozitat e nenit 71, paragrafi 2, nën-paragrafi 2 i KPPK-së, i cili thotë *"nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjithë dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkaloj periudhën prej njëzet vjetësh".* Gjykata thekson se kriteri i dënimit unik është një kriter i detyrueshëm, në varësi të parametrave të përcaktuara se, në të gjitha rrethanat e rastit, dënimi unik i duhur është katër (4) vjet burg.

I akuzuari ka qenë në paraburgim që nga 01 Korrik 2011 dhe në pajtim me dispozitat e nenit 73, paragrafi 1 i KPPK-së dhe nenit 393, paragrafi 1, nën-paragrafi 5 i KPPPK-së, koha e kaluar në paraburgim që prej 01 Korrik 2011, deri në datën e sotme, duhet të llogaritet kundrejt dënimit.

Në përcaktimin e dënimit të zbatueshëm, Trupi Gjykues thekson dispozitat e nenit 3, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Ligji 04/L-082 të datës 20 Prill 2012)

(më tej do të referohet si “KPK”), që thotë në nenin me titull *“Aplikimi i ligjit më të përshtatshëm”* në paragrafin 2 se *“në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm”*. Trupi gjykues ka marrë në konsideratë këtë dispozitë dhe ka përcaktuar se KPK-ja nuk i garanton të akuzuarit ndonjë avantazh në lidhje me dispozitat e dënimit që kanë të bëjnë me akuzën e narkotikëve apo me krimin e organizuar.

**KONFISKIMI**

Trupi gjykues gjithashtu ka përcaktuar se, në pajtim me dispozitat e nenit 54, paragrafi 2, nën-paragrafi 7, dhe nenit 60, paragrafi 1 i KPPK-së, që telefoni i përdorur nga i akuzuari ishte subjekt i një kërkese për konfiskim nga ana e Prokurorit, mbi baza që telefoni ka asistuar në kryerjen e veprave për të cilat Z. S.T. ka pranuar fajësinë. Në rrethanat kur një pjesë e madhe e konsiderueshme e provave në këtë lëndë përfshijnë përgjimet telefonike dhe grupi ishte angazhuar në kontakte të rëndësishme, trupi gjykues nuk ka ndonjë hezitim për të urdhëruar konfiskimin e telefonit të Z. S.T. me të dhënat si në vijim:

1. *Telefon celular Nokia, me ngjyrë të zezë, modeli 1280, që është i S.T., me numër IMEI 355926/04/360261/1*

**SHPENZIMET**

Sipas nenit 102, paragrafi 4 i KPPPK-së, i akuzuari lirohet nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale që do të paguhen nga burimet buxhetore.

**Më 13 Mars 2014, në Prishtinë**

**Kryetari i Trupit Gjykues**

________________________________

**Mariola PASNIK**

| | |
|---|---|
| **Anëtar Kolegji** | **Anëtar Kolegji** |
| ________________________ | ________________________ |
| **Suzana CERKINI** | **Marie TUMA** |

**Procesmbajtësi**

________________________________

**David HEGARTY**

**MJETI JURIDIK:**

Sipas nenit 398 paragrafi 1 i KPPPK-së, personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit

## ANEKSI 1

## PROVAT E BASHKANGJITURA NË DOSJEN E GJYKATËS *ex-officio* NGA GJYKATA

1. AKTGJYKIMI P.Kr.Nr. 22/13 i dorëzuar më 18 Mars 2013 kundër PANDEHURIN A.K. dhe XH.T.; Gjykata Themelore e Prishtinës; Kryetari i Trupit Gjykues, Pineles.

## ANEKSI 2
## PROVAT NË TË CILAT ËSHTË MBËSHTETUR PROKURORIA

<u>MATERIALET NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË</u>

1. Raporti i policisë mbi operacionin, datë 26, 28, 29 dhe 30.09.2009
   (DOSJA XXVI pp. 2359-2361 (përfshirë videon dhe fotot e bashkangjitura të shënuara “CD3”) [angleze], pp. 2461-2466 [shqipe]

2. Raporti i shërbimit të policisë nga Shqipëria, datë 1, 2, 3 dhe 5.10.2009
   DOSJA XXII pp. 2373-2378 [angleze], pp. 2467-2472 [shqipe]

3. Raporti i zyrtarit policor lidhur me 25.11.2009
   DOSJA XXIV pp. 1644-1645 [angleze], pp. 1637-1639 [shqipe]

4. Raporti i zyrtarit policor lidhur me 16 dhe 22.10.2009
   DOSJA XXIV, pp. 1649-1650 [angleze]

5. Raporti i zyrtarit policor lidhur me 7, 8 dhe 9.10.2009
   Dosja XXIV, seksioni 3, pp 1650-1653 [angleze], Dosja XXVI, seksioni 3 [shqipe]

6. Procesverbal i kontrollimit të Mercedes Benz, me [tabela të regjistrimit]
   DOSJA XXIV, seksioni 6, pp 1975-1980 [angleze], DOSJA I (S.T.), pp 271-281 [shqipe]

7. Raporti mbi konfiskimin e gjërave nga Policia e Shqipërisë
   DOSJA XXIV, seksioni 6, pp 1981-1982 [angleze], pp. 1922-1923 [shqipe]

8. Analiza e ekspertit të forenzikës së Republikës së Shqipërisë mbi substancat e gjetura pas konfiskimit
   DOSJA I (S.T.), pp. 247-252 [angleze], DOSJA XXIV, seksioni 6, pp 1992-1997 [shqipe]

9. Raport nga Republika e Shqipërisë lidhur me konfiskimin e kamionit (të S.T.t) datë 30.11.2010 (përfshirë fotografitë e shënuara "CD5")
   DOSJA XXVI, seksioni 10 [shqipe]

MATERIALET NGA KOSOVA

10. Raporti i Policisë së Kosovës mbi Vëzhgimin e datës 5.08.2009, 2 deri 5.09.2009 dhe 19.11.2009.
    DOSJA i Policisë V, seksioni 12, pp 1751-1757 [angleze], pp. 1744-1750 [shqipe]

11. Raporti i Policisë së Kosovës mbi Vëzhgimin e datës 3, 4, 5 shtator 2009
    DOSJA i Policisë V, seksioni 12, pp 2578-2583 [angleze]

12. Plotësim i Raportit të Vëzhgimit datë 24.05.2010 me fotografi
    DOSJA i Policisë VI, seksioni 3 dhe fotografitë e shënuara "CD1", "CD2" dhe "CD 4, seksioni 1" pp. 1798 [shqipe]

13. Raporti i Policisë së Kosovës datë 3 mars 2010; raporti final i përgjimit mbi rezultatet dhe analizat – 'përmbledhje e të dyshuarve'
    DOSJA V, seksioni 11, pp. 1654-1701 [angleze], pp. 1702-1743 [shqipe]

14. Raporti i policisë së Kosovës datë 16 qershor 2010 (Ref: 2008-XZ-039) lidhur me hetimin financiar.
    DOSJA VI, seksioni 7, pp. 2035-2038 [angleze], pp.2039-2042 [shqipe], pp. 2043-2088

15. Raporti i Policisë së Kosovës mbi Rezultatet e Hetimit Financiar datë 17 dhjetor 2010
    DOSJA IX

16. Raporti i Bastisjes i Policisë së Kosovës i shtëpisë së Xh.T., datë 27.5.2010
    DOSJA i Policisë VI, volumi 6, seksioni 3, pp 1804-1886 (me fotografi)

17. Marrëveshja e debitorit e konfiskuar gjatë bastisjes së shtëpisë së Xh.T. më 27.5.2010
    DOSJA i Policisë VI, volumi 6, seksioni 3, pp 1808-1812

18. Raporti i Bastisjes i Policisë së Kosovës i shtëpisë së A.K.-t, datë 27.5.2010
    DOSJA i Policisë VI, volumi 6, pp 1968-1191

19. Raporti shtesë i Policisë së Kosovës datë 31.5.2010 (2008-XZ-029)
    Dosja i Policisë VI, volumi 6, seksioni 4, pp 1927-1930

20. Raport mbi ekzaminimin forenzik (Ref: 2008-XZ-039) mbi gjërat e konfiskuara gjatë bastisjes së shtëpive të A.K.-t dhe Xh.T.

21. Raporti i Doganës së Kosovës për G.I.-n, datë 4 dhjetor 2010

22. Raporti i Policisë Rajonale Kufitare për G.I.-n, datë 4 dhjetor 2010

23. Urdhri nga Zyrtari i Lartë Policor K.G. për G.I.-n, datë 30 nëntor

24. Raporti i Policisë së Kosovës mbi transkriptet mbi përgjimin e CD-ve nga Shqipëria, 17.11.2009-25.11.2009, datë 1 mars 2010;
DOSJA V, seksioni 10, pp. 1594-1653 [angleze], pp. 1598-1653 [shqipe]

25. Të gjitha transkriptet në dosjen kryesore të përgjimeve (me CD-në e bashkangjitur të përgjimeve)
DOSJA XI

26. Rezultatet e analizave mjeko-ligjore e SIM kartelës së S.T.

27. Raporti Ekspert për Analiza Voice titulluar Fjala dhe Analiza Audio nga Scientist Ligjore T.N. të Laboratorit Forenzikës e Zyrës Kombëtare të Hetimit të Finlandës, datë 2012/12/01 me CD e regjistrimeve të dërguara për analiza përfshirë interceptimin dhe regjistrimin e dëgjimit të të pandehurit prej 9 gusht 2011

28. Deklaratat e S.T. të Prokurorit të datës 2 gusht 2011, 9 gusht 2011, dhe 6 mars 2014

## SHTOJCA - LISTA E PËRGJIMEVE

**LISTA E NUMRAVE TE TELEFONIT DHE SHFRYTEZUESVE**

**Xh.T.**

[Tel. nr.] Kosove
[Tel. nr.] Kosove
[Tel. nr.] Shqipëri
[Tel. nr.] Shqipëri
[Tel. nr.] Holandë
[Tel. nr.] Holandë
[Tel. nr.] Holandë
[Tel. nr.] Holandë
[Tel. nr.] Kosovë

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin:</u>* - Pranimi i Xh.T. i në seancat me prokurorin, informacioni i dhëne nga IPKO dhe VALA, PK Databaza, dokumentacioni ILA nga Shqipëria dhe regjistrimet e zërit, emri i përdorur gjatë thirrjeve të përgjuara, gjykimi i 04.07.2011

**A.K.**

[Tel. nr.] Kosove

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin:</u>* - Pranimi i A.K. në seancat me prokurorin, informacioni i marre nga VALA, PK Databaza, emri i përdorur gjatë thirrjeve të përgjuara.

**S.T.**

[Tel. nr.] Shqipëri
[Tel. nr.] Shqipëri

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin:</u>* - Pranimi i pjesërishëm i të akuzuarit në seancat me prokurorin, përgjigje nga Shqipëria, marrja ne pyetje e te bashkë-akuzuarit Xh.T., emri ose term tjetër identifikimi i përdorur gjatë thirrjeve të përgjuara p.sh. “Xhaxhai Sl.” [S.T.] 'ose' “Baca Sl.” [S.T.] ', ekspertiza zëri

**G.G.**

[Tel. nr.] Shqipëri
[Tel. nr.] Shqipëri

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin:</u>* - dokumentacioni ILA nga Shqipëria, regjistrimet zëri, marrja ne pyetje e Xh.T..

**G.I.**

[Tel. nr.] Kosove

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin:</u>* - Pranimi I pjeserishem i G.I. në seancat me prokurorin & gjate dëshmimit në gjyq- arsyetimi se ai kishte dhene hua atë një pale të tretë të paidentifikuar nuk u gjet e besueshme nga trupi gjykues, regjistrimet zanore, SMS përkatëse te përgjuara, të pranuara nga kolegu.

**B.T.**

[Tel. nr.] Kosove

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin</u>* - Emri dhe terme tjera identifikuese të përdorura gjatë thirrjeve dhe sms të përgjuara 'Daja Be.’ etj, transkriptet përkatëse, rezultatet e matjes.

**H.T.**

[Tel. nr.] Holandë
[Tel. nr.] Holandë
[Tel. nr.] Holandë
[Tel. nr.] Kosovë
[Tel. nr.] Holandë (ka përdorur linjën bashke me A.T.-in)

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin</u>* – Procesverbali i marrjes në pyetje të Xh.T., emri dhe termet tjera identifikuese të përdorura gjatë thirrjeve të përgjuara dhe SMS, transkriptet përkatëse.

**A.T.**

[Tel. nr.] Holandë

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin</u>* – procesverbali i marrjes në pyetje të Xh.T. dhe A.K., emri dhe termet e tjera identifikuese të përdorura gjatë thirrjeve të përgjuara dhe SMS, transkriptet përkatëse.

**Z.T.**

[Tel. nr.] Shqipëri

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin</u>*: - Emri dhe termet tjera identifikuese të përdorura gjatë thirrjeve të përgjuara dhe SMS, transkriptet përkatëse, PK baza e të dhënave.

**“M.”**

[Tel. nr.] Shqiperi

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin</u>* - emri dhe termet tjera identifikuese të përdorura gjatë thirrjeve të përgjuara dhe SMS, dokumentacioni ILA nga Shqipëria.

**“Il.”**

[Tel. nr.] Shqipëri

*<u>Dëshmi qe vërteton zotërimin</u>* - emri dhe termet tjera identifikuese të përdorura gjatë

thirrjeve të përgjuara dhe SMS, dokumentacioni ILA nga Shqipëria

**PËRGJIMET E KOSOVËS**

(1) **21.04.2009** në ora **11:49:40 [Tel. nr.]** A.K. SMS për [Tel. nr.] (Xh.T.*)* *(Përgjimi i dosjes III, f. 712)*

A.K. i kërkonte Xh.T.s ti dërgonte atij para për të bërë biznesin e tyre

(2) **28.04.2009** në ora **15:24:27 [Tel. nr.]** A.K. SMS për [Tel. nr.] (Xh.T.) *(Përgjimi i dosjes III, p.778)*

Xh.T. dhe A.K. diskutojnë për gjetjen e një "veture", që dyshohet të ketë qenë një korier.

(3) **03.06.2009** në ora **18:59:35 [Tel. nr.]** A.K. SMS nga [Tel. nr.] (Xh.T.) *(Përgjimi i dosjes III, f. 742)*

A.K. i kërkonte Xh.T.s ti dërgonte atij para për të kryer biznesin e tyre

(4) **04.06.2009** në ora **22:42:52 [Tel. nr.]** A.K. SMS për [Tel. nr.] (Xh.T.) *(*Përgjimi i dosjes *III, f. 758),*

A.K. dhe Xh.T. diskutojnë rrugën e dërgimit.

(5) **04.06.2009** në ora **22:48:27 [Tel. nr.]** A.K. SMS nga [Tel. nr.] (Xh.T.) *(*Përgjimi i dosjes *III, f. 759),*

A.K. dhe Xh.T. diskutojnë rrugën e dërgimit.

(6) **04.06.2009** në ora **22:49:08 [Tel. nr.]** A.K. SMS për [Tel. nr.] (Xh.T.) *(*Përgjimi i dosjes *III, f 760),*

A.K. dhe Xh.T. diskutojnë rrugën e dërgimit.

(7) **04.06.2009** në ora **22:50:59 [Tel. nr.]** A.K. SMS nga [Tel. nr.] (Xh.T.) *(*Përgjimi i dosjes *III, f. 761),*

A.K. dhe Xh.T. diskutojnë rrugën e dërgimit – Mali i Zi.

(8) **27.07.2009** në ora **14:42:58 [Tel. nr.]** Xh.T. I thirrur nga [Tel nr.] (S.T.) *(Përgjimi i dosjes XI, f. 18-19))*

Xh.T. pati një bisedë telefonike me S.T. ku Xh.T. e pyeti nëse ai ishte nisur - se "ne jemi në këtë anë". S.T. u përgjigj: "në çdo kohë që ju dëshironi". Xh.T. tha se ai është i gatshëm, në çdo kohë që ai do të donte ai mund të vijë për shkak se "unë mund të shkoj për 2-3 ditë në Slloveni".

(9) **27.07.2009** në ora **16:29:58 [Tel. nr.]** Xh.T. I thirrur nga [Tel nr.] (S.T.) (Përgjimi i dosjes *IV, f.1058))*

Xh.T. ka pasur bisedë me S.T. Xh.T. e pyet “S.T.; "kur do të vish?”. S.T. u përgjigj: "kur ju do të më thoni". Xh.T. thotë: "Unë jam i gatshëm, në çdo kohë që ju dëshironi, unë mund të vijë". S.T. u përgjigj duke thënë se ai mund të vijë nesër.

(10) **27.07.2009** në ora **20:03:34 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] (H.T.) *(*Përgjimi i dosjes *XI, f. 26-33).*

H.T. nga Holanda, thërret Xh.T. për të diskutuar mbi një person me emrin G.G. nga Shqipëria. H.T. kishte folur me G.G.-in lidhur me një dërgesë narkotike, por H.T. i kishte thënë Xh.T. se dërgesa "nuk mund të bëhej para shtatorit për shkak se ata djem nuk do të ktheheshin deri atëherë". Gjatë kësaj bisede, ata përmendin një person me pseudonimin "i Vogli", pastaj Boshnjak, “Gi.”, ndërsa diskutuan çmimin duke përdorur kodin 104. H.T. pyet Xh.T. se “çfarë ka ndodhur me atë që kishim blerë bashkë?”. Xh.T. përgjigjet duke thënë se "u bë fenomenal me ato nga Zvicra". Pastaj, Xh.T. përmend S.T., për të cilin ai tha se kishte paguar vazhdimisht.

(11) **28.07.2009** në ora **21:53:00 [Tel. nr.]** Xh.T. I thirrur nga [Tel. nr.] (S.T.)

S.T. foli me A.T. nga telefoni i Xh.T., ku ai kërcënoi të shesë kamionin Scania, në mënyrë që të paguajnë faturat e spitalit për djalin e tij. S.T.: *"A.T. ju duhet të sqaroheni me Xh.T., H.T.-n dhe G.G., që unë të mund ta përfundojë punën...përndryshe edhe unë kam makinë të cilën do ta shes dhe paguaj borxhin tuaj...").*

*Kjo bisedë lidh S.T.-n me XH.T.-n, H.T.-n dhe A.T.-in në lidhje me transportimin e drogës në kamionin Scania.*

(12) **28.07.2009** në ora **21:58:26 [Tel. nr.]** (A.T. duke përdor telefonin e Xh.T. Xhaqit) thirrur nga [Tel. nr.] (S.T.) *(Dosja e përgjimit XI, f.41-43).*

S.T. ka përdorur telefonin e Xh.T. për të biseduar me A.T.n i cili gjendet në Holandë. S.T. ia kërkoi atij 10 mijë eurot të cilat ia kanë borxh A.T. dhe H.T. Ata gjithashtu përmendën G.G. dhe Korabin, birin e S.T. S.T. ka kërcënuar se do të shesë kamion në mënyrë që të paguajnë faturat e djalit të tij në spital. S.T.: "A.T. ju duhet të sqaroheni me Xh.T., H.T.-n dhe G.G., që unë të mund ta përfundojë punën...përndryshe unë e kam makinën, të cilën do ta shes dhe paguaj borxhin tuaj...").
*(Dosja e përgjimeve XI, 28.07.2009 në ora 21:58:26, f. 41-43).*

*Është deklaruar se paratë borxh për të pandehurin S.T. ishin për pjesën e tij në transportin e drogës, veçanërisht për furnizimin e kamionit Scania, për t’u përdorur për atë qëllim.*

(13) **28.07.2009** në ora **22:07:38 [Tel. nr.]** (A.T. duke përdorur telefonin e Xh.T.) thirrur nga [Tel. nr.] (”Bo.”) *(Dosja e përgjimeve XI, pp.44-46*)

A.T. dhe Xh.T. diskutuan mbi paratë që ata ia kanë borxh S.T. Xh.T. tha se S.T. "bëhet nervoz, ai tha se në qoftë se ju nuk m’i jepni mua paratë, unë do të shesë kamion". Sipas këtyre bisedave dhe atyre të mëvonshme, kamioni i cili është drejtuar nga S.T. u ble bashkërisht nga Xh.T., H.T. dhe A.T.-i për transportimin e narkotikëve.

(14) **28.07.2009** në ora **22:10:35 [Tel. nr.]** Xh.T. I thirrur nga [Tel. nr.] (”Bo.”) (*Dosja e përgjimeve XI, pp.47-52*)

Xh.T. dhe A.T.-i diskutojnë më tej për paratë që ata ia kanë borxh S.T.T, i cili e organizoi transportimin e narkotikëve në Holandë. H.T. tha: "Unë i kam thënë “Sl.” [S.T.] se do t’i ndihmojë me 10.000, por ne nuk e kemi përfunduar akoma punën tonë". Në diskutimin se sa lek ai ia kishte dhënë G.G.-ës, H.T. ka përmendur shumën 28. Pas kësaj, A.T.-i e ka njoftuar Gjermaninë mbi përfundimin e punës.

(15) **28.07.2009** në ora **22:39:38 [Tel. nr.] Xh.T.** I thirrur nga [Tel. nr.] *(Dosja e përgjimit IV, faqe 1081)*

Xh.T. dhe H.T. diskutojnë mbi paratë që ata i detyrohen S.T. G.G., dhe poashtu kamioni të cilin S.T. tha se do ta shiste po që se nuk do të paguhej.
“H.T.: Daja “Sl.” [S.T.]o nuk është aty?: Xh.T.: “jo, ai sapo shkoi”

(16) **29.07.2009** në ora **11:35:40 [Tel. nr.]** Xh.T. I thirrur nga [Tel. nr.] (H.T.) (*Dosja e përgjimit XI, pp.55-57*)

Xh.T. ka folur me H.T.-n në [tel. nr.]. H.T. ka kërkuar nga Xh.T. që t'ia ipte atij, numrin e S.T.T në Shqipëri. Xh.T. ia kishte dhënë [Tel. nr.], i cili përdoret nga S.T.. H.T. i sugjeroi Xh.T. që të shkoj në qytetin KU, në Maqedoni [Kumanovë] dhe të fliste me një tjetër bashkëpunëtor në lidhje me transportin e drogës. H.T. tha se "çmimi i tij është fiks 10 mijë euro edhe për dërgesa më të mëdha, por unë do ta paguaj më shumë atë, deri në 20 mijë për dërgesë".

(17) **29.07.2009** në ora **11:55:16 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] (H.T.)

(18) **29.07.2009** në ora **19:36:06 [Tel. nr.]** Xh.T. I thirrur nga [Tel. nr.] (S.T.) (*Dosja e përgjimeve XI, f.58-60*)

S.T. thërret XH.T.-n. Ata diskutuan dërgesën të cilën S.T. dëshironte ta transportonte në Kosovë tek Xh.T.. S.T. i thotë Xh.T. të mos e informojë askënd dhe t'i shmanget G.G.-ës.

(19) **03.08.2009** në ora **17:52:08 [Tel. nr.]** Xh.T. I thirrur nga [Tel. nr.] *(Dosja e përgjimit XI, pp.63-64*)

Xh.T. foli me G.G. në telefon dhe i tha atij se; "daja, daja do të vijë nesër tek ju, sepse ai ka një biznes të vogël [për] ju". Xh.T. tha "pse ai nuk e pëlqeu atë?" UMP tha: "Po, ai kishte [punuar] pak me ju". Xh.T. u përgjigj: "Unë do të jem nesër në Maqedoni, kështu që thoni xhaxhait le të vijë pasnesër".

(20) **03.08.2009** në ora **17:59:57 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] (A.K.) *Dosja e përgjimit XI, f.64-65)*

A.K. i thotë Xh.T.s: "Më duhet t'ia dërgoj veturën A.T.-it").

(21) **03.08.2009** në ora **19:25:27 [Tel. nr.]** Xh.T. thërret [Tel. nr.] (A.K.) *(Dosja e përgjimit XI,f. 66)*

Xh.T. foli me A.K., duke e pyetur atë "a jeni bashkë?" A.K. tha"ne jemi bashkë dhe po vijmë tek ju". Xh.T. i thotë A.K. : "thuaj që për një javë do të ti gjej diku rreth 50.000 euro për nja 5-6 ditë të gjitha para kesh, ok, ok".

(22) **03.08.2009** në ora **21:37:53 [Tel. nr.]** Xh.T. I thirrur nga [Tel. nr.] (S.T.) *(Dosja e përgjimeve XI, pp.77-78)*

S.T. i tha Xh.T. se ai ishte "urdhëruar që të vijë përsëri te ju me automjete, unë tash sa e kam kaluar kufirin dhe jam udhës për në Prizren, unë do të fle diku në automjet dhe nesër në orën 8, do të të thërras me telefon dhe do të shkojmë atje." Xh.T. u përgjigj se "tani është vonë për të ardhur tek ne, sepse ne nuk mund të hyjmë". S.T. tha "jo, sepse unë do të vijë nesër".

(23) **04.08.2009** në ora **21:41:11 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] ("Sa.")*(Dosja e përgjimeve XI, (pp.69-76, 75)*

Xh.T. thote: "Unë isha në Holandë për 3 muaj".

(24) **05.08.2009** në ora **12:37:32 [Tel. nr.]** Xh.T. thërret [Tel. nr.] [G.G.] *(Dosja e përgjimeve XI, pp.77-78*)

Xh.T. i tha G.G.-ës se; "Unë jam këtu me dajën "Sl." [S.T.]", ndërsa G.G. u përgjigj: "Unë jam në Kukës dhe brenda 30 min do të vijë të takohem me dajën, sepse unë kam ardhur për atë çështje, për ta marrë atë, ai do të vijë përsëri me mua". Më vonë, G.G. i tha Xh.T. që ta "marrë H.T.-n sepse ai më tha se do të largohet "Go." dhe unë do t'ju jap paratë". Xh.T. i tha G.G.-it se; "kur të vishë, ne do të flasim".

(25) **05.08.2009** në ora **14:48:43 [Tel. nr.]** Xh.T. SMS për [Tel. nr.] (*Dosja e përgjimeve XI, p.79*)

Xh.T. i dërgon një SMS në numrin [Tel. nr.] me këtë përmbajtje: "S.T. Amsterdam", dhe pastaj "Amsterdam Tirana". Kjo ishte një kërkesë për marrësin për të blerë një biletë për "S.T. për të udhëtuar në Holandë.

(26) **05.08.2009** në ora **15:13:52 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] (H.T.) *(Dosja e përgjimeve XI, pp.81-82)*

Xh.T. flet me H.T.-n në Holandë. Ai i tha atij: "Unë jam në Vërmicë me G.G.-in dhe "Sl." [S.T.]" dhe e pyeti për numrin e një kolegu në Shqipëri. H.T. ia dha numrin [Tel. nr.] (Zenel).

*Fakti që ky takim u zhvillua vërtetohet nga fotografitë dhe videot nga mbikëqyrja e Policisë së Kosovës, më datë 5 gusht 2009, në të cilin takim është parë Xh.T. në takim me G.G. në restorant "Il."ia në Vërmicë. Fotografitë e takimit të tyre janë emërtuar "CD 1". Unë gjithashtu i referohem raportit të Gjykatës, Doja Policore VII, pp. 2124-2125.*

(27) **05.08.2009** në ora **16:07:35 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] (A.T.) (*Dosja e përgjimeve XI, pp.84-86*)

Xh.T. foli me A.T.-in në numrin e telefonit [Tel. nr.]. Xh.T. i tha A.T.-it se; "Unë jam me "Sl." [S.T.] dhe G.G.-n". A.T.-i i tha Xh.T. "ok shkoni në vendin tim dhe merrni 4.500 €, sepse unë do t'ju jap ato këtu". S.T. pastaj u bashkua në bisedë, me ç'rast A.T.-i i tha atij se "tani një mik i H.T.-t do të sjellë 4500 €". S.T. tha "OK". Këto para janë borxhi që A.T.-i, H.T., dhe Xh.T. ia kishin S.T., për transportin të mëhershëm të drogës.

(28) **05.08.2009** në ora **16:14:44 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] (Z.T.)

Z.T. thëret XH.T.-n. Xh.T. I thotë Z.T.t "mos merr nga ai sepse unë kam dëgjuar që I ke marrë. Mendoj që ai e ka kryer atë.

(29) **05.08.2009** në ora **16:16:24 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] (H.T.)

H.T. calls Xh.T. and tells him that noë a friend of his (daja Hys) do ta thërras atë dhe do ta sjellë "atë" përmes dikujt. Xhama ia kthen "mirë sepse ata do të shkojnë pas një ore e din ti?" H.T.-a I thotë Xh.T. "ok, sapo ai t'I bën 4,500 ai do t'I jap ty"

*Kjo dyshohet t'I referohet fitimit nga shitja e narkotikëve.*

(30) **05.08.2009** në ora **17:30:40 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] ("Da.")

"Da." thërret Xh.T. Xh.T. I thotë "Da.-ës" "biseda që ti ke pas "serbs'…"'Da.' përgjigjet "po, jam I gatshëm, ata pop resin për mua. Por do të vijë këtë javëdhe do të bisedojmë". Xh.T. diskuton qmimin.

(31) **05.08.2009** në ora **18:13:04 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.]

Xh.T. informon një kolegë tjetër se " Baca Sl." [S.T.] thotë që mbaruam punë".

(32) **05.08.2009** në ora **22:20:35 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] (""Go."")

"Go." I thotë Xh.T.-t se ai do të "iu dërgojë 4,500 të tjera". Xh.T. thotë "Unë I kam marrë ata për në kufi".

(33) **12.08.2009** në ora **21:32:32 [Tel. nr.]** Xh.T. SMS për [Tel. nr.] (V.G.) *(Dosja e përgjimeve XI, p.103)*
Xh.T. i dërgoj një mesazh SMS të dashurës së atëhershmë të tij, V.G., duke i thënë "të Shtunën [15.08.2009] Unë do shkoj në Shqipëri me Q.T. sepse kemi punë".

(34) **12.08.2009** në ora **21:33:27 [Tel. nr.]** Xh.T. SMS from [Tel. nr.] *(Dosja e përgjimeve IV, p.1187)*
*bashkëpunëtor "100kg mish, Unë do të përfundoj punën"*

(35) **17.08.2009** në ora **16:34:13 (0) 44 968 495** Xh.T. SMS from [Tel. nr.] *(Dosja e përgjimeve IV, p.1247)*

Xh.T. pranoi një mesazh nga një tjetër bashkëpunëtor që i premtonte ti sjell atij 70 mijë euro.

(36) **20.08.2009** në ora **17:58:08 [Tel. nr.]** A.K. dërgoi SMS për [Tel. nr.] (Xh.T.) *(Dosja e përgjimeve VII, p.1785)*

A.K. këshilloj Xh.T. për të "thirrur "Ad."n [Tel. nr.]" in Zvicër.

*"Ad." dyshohet të jetë diler-ndërmjetësues I grupit criminal në Zvicër. Xh.T. është drejtuar për të thirrur atë në mënyrë që të kryhet marrëveshja.*

(37) **24.08.2009** në ora **22:00:53 [Tel. nr.]** A.K. thërret [Tel. nr.]

Xh.T. dërgoi një SMS mesazh te një bshkëpunëtorë duke thënë "dajë nesër jam te ti, mi dërgo ca para se jam në pozitë të keqe dhe ne do të flasim për këtë sepse njerëzit po më bëjnë presion mbi mua".

(38) **25.08.2009** në ora **15:27:46 [Tel. nr.]** A.K. i thirrur nga [Tel. nr.] ("Ad.") ( *Dosja e përgjimeve VII, pp.1790-1792)*

A.K. foli me "Ad.-n" në Zvicër I cili përdor numrin telefonik [Tel. nr.]. "Ad." I tha A.K.: "Do ta dërgoj "Ar.", mbaro punë me të". Ai përmendi shifrën e "12 mijë euro" për "automjet". A.K. oferton për të filluar organizimin e dërgesës në kthim për 1,000.

*Këto shifra i referohen blerjes dhe shitjes së narkotikëve. Prandaj, A.K. organizoj dërgesë të narkotikëve me "Ad."n në Zvicër. Bazuar në qmim, droga në fjalë është Heroin. Ar"Be." është korier I siguruar nga Adnan.*

(39) **28.08.2009** në ora **11:55:46 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.]

(40) **28.08.2009** në ora **12:46:12 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.]

(41) **28.08.2009** në ora **17:21:23 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.]

(42) **01.09.2009** në ora **12:01:09 [Tel. nr.]** Xh.T. duke thirrur [Tel. nr.] *(Dosja e përgjimeve XI, pp.109-110).*

Xh.T. pyet bashkëpunëtorin e vet “a do të ishte problem nëse ata do të ishin prej Sllovenisë?” dhe me miratimin, deklaroi “Unë do të shkojë jashtë për të takuar ata njerëz”.

*Kjo bisedë I referohet korierëve.*

(43) **01.09.2009** në ora **12:09:36 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga numër i panjohur i jashtëm *(Dosja e përgjimeve XI, p.111-113, 113).*

Xh.T. foli me bashkëpunëtorin e tij në Itali duke e informuar atë që ai kishte “lajme të mira” pork a nevojë për para të “nis automjetin” për Itali

(44) **01.09.2009** në ora **21:54:09 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] [G.G.] *(Dosja e përgjimeve XI, pp.115-16)*

*Xh.T. dhe G.G. diskutojnë organizimet e fundit mbi korierët, pagesat ndaj korierëve, rruga dhe destinacioni i dërgimit të drogës*

Xh.T. i thotë atij se “ai njeri mund të niset por vetëm deri te uji [Itali] ai [kërkoi] 1000 Euro për Kg. Dhe deri te kalimi [Zvicër] ai kërkoi 1700 për automjet [kg]”. Xh.T. dhe bashkëpunëtori pastaj u pajtuan për t’u takuar në Shqipëri.

*Kjo thirrje është interpretuar për të trajtuar qështjen e kostos së korierit. Kjo shumë pretendohet të barazohet me koston e transportit të heroinës.*

(45) **02.09.2009** në ora **16:44:57 [Tel. nr.]** Xh.T. thërret [Tel. nr.] (V.G.) *(Dosja e përgjimeve XI, pp.118-119)*

V.G., e dashura e atëhershme e Xh.T. e pyeti atë “ku je?” Xh.T. u përgjigj duke thënë “jam me Qere [Q.T.] gati në kufi”.

(46) **02.09.2009** në ora **16:48:50 [Tel. nr.]** Xh.T. thërret [Tel. nr.] [G.G.] *(Dosja e përgjimeve XI, p. 120)*

Xh.T. i thotë G.G.s: “Jam duke ardhur në drejtim tuajin, me njeriun tim, jemi bashkë. *“Këtë timin” i referohet Q.T. G.G. i thotë atij “Mirë, unë jam në punë”.*

(47) **02.09.2009** në ora **19:44:08 [Tel. nr.]** A.K. thërret [Tel. nr.] (Xh.T.) *(Dosja e Përgjimit XI, f.123-124)*

A.K. krijoi kontakt me XH.T.-n. A.K. i tha Xh.T.: “Derisa je në Shqipëri, shiko nëse

mund ta thërrasësh Astritin dhe të takohesh me të". Xh.T. i tha A.K.: "Nesër merru vesh mirë me të se kur dhe si mund të kryejmë punën".

*Ky qe Xh.T. duke këshilluar A.K.-n të bëjë aranzhimet përfundimtare për korrierët nga Kosova për çuarjen e dërgesave më tutje.*

(48) **02.09.2009** në ora **21:19:50 [Tel. nr.]** A.K. thërret [Tel. nr.] (Xh.T.) *(Dosja e përgjimeve XI, f.129-130)*

A.K. foli me Xh.T.. Xh.T. i thotë A.K.: "Rregulloi detyrat mirë sepse këta do të vijnë". A.K. i tha Xh.T. që ai do të donte ta ndërronte automjetin e tij dhe do të dëshironte të ikte të Premten. Xh.T. shkoi në Shqipëri në mënyrë që të rregullonte dërgesën e substancave narkotike për Kosovë. Roli i A.K. ishte të organizonte dhe përgatiste korierët për transportim të mëtutjeshëm të drogave për në Zvicër dhe vende tjera. Xh.T. i thotë A.K. të "jetë i siguruar sepse këto do të vijnë nesër tek unë dhe menjëherë duhet të dërgohet sepse mund të mos qëndrojë tek unë, duhet ta kesh parasysh këtë".

*Kjo bisedë tregon që A.K. aranzhoi korierët mbi udhëzimet e Xh.T.-t.*

(49) **03.09.2009** në ora **11:46:20 [Tel. nr.]** A.K. i thirrur nga [Tel. nr] ("F.") (*Dosja e përgjimeve VII, p. 1906-1907*)

A.K. foli me "F.". "F." pyeti A.K.-n nëse ai ka "përfunduar punën". A.K. përgjigjet duke thënë që ai "ka shkuar në Shqipëri" dhe po pret të dëgjoi nga Xh.T. në lidhje me dërgesën të cilën pritet të arrijë në Kosovë.

(50) **03.09.2009** në ora **12:58:51 and 13:01:35 (2 pjesët) [Tel. nr.]** A.K. i thirrur nga [Tel. nr.] (*Dosja e përgjimeve VII, p. 1903)*

Xh.T. dërgoi një SMS mesazh te A.K. duke thënë "ata janë në Kukës, duke ardhur të unë, ti bën qka të mundesh sepse ne nuk mund t'I gënjejmë ata, më kupto sepse gjërat mudn të shkojnë keq, dajë ti flet mirë sepse unë me të vërtetë e kam organizuar biznesin, Unë do të tregojë kur të vijë atje".

(51) **04.09.2009** në ora **11:59:48 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] (A.K.) *(Dosja e përgjimeve XI, pp. 152-153)*

*A.K. përXh.T.: "për gjysmë ore I marr detajet [e]atij se kush është…atij nuk ja ndin për [eja] ende").*

*Kjo bisedë I referohet korierit.*

*Përgjimet rreth kohës së njëjtë tregojnë që Xh.T. u bë nervoz dhe vazhdimisht bëntë presion mbi A.K.-n që të sigurohej që korierët ishin gati.*

(52) **04.09.2009** në ora **12:09:05 [Tel. nr.]** Xh.T. SMS për [Tel. nr.] (*Dosja e përgjimeve VII, p. 1204*)

Xh.T. dërgojë një SMS mesazh te një bashkëpunëtorë shqiptarë "dajë, nuk mund të marr"

(53) **04.09.2009** në ora **15:34:13 [Tel. nr.]** Xh.T. SMS për [Tel. nr.] (*Dosja e përgjimeve XI, f. 156*)

Xh.T. dërgoi një SMS mesazh tek I njëjti numër si më parë, me përmbajtjen: "në 23:00 ai shoku do të mbërrijë, dajë".

(54) **04.09.2009** në ora **17:07:46 [Tel. nr.]** Xh.T. SMS prej [Tel. nr.] (*Dosja e përgjimeve XI, f. 157*)

Xh.T. pranon një SMS mesazh nga një bashkëpunëtorë shqiptarë, me përmbajtje: "rreth orës tetë pasditë ai do të jetë te vendi juaj.

(55) **04.09.2009** në ora **20:33:57 [Tel. nr.]** Xh.T. SMS për [Tel. nr.] (*Dosja e përgjimeve VII, p. 1208*)

Xh.T. dërgoi një SMS me tekstin: "dajë, eja tek vendi im?"

(56) **04.09.2009** në ora **20:47:02 [Tel. nr.]** Xh.T. thërret [Tel. nr.] (S.T.) (*Dosja e përgjimeve XI ,f. 159-160*)

Xh.T. foli në telefon me një bashkëpunëtorë shqiptar i cili përdorte numrin [Tel. nr.]. Xh.T. pyeti atë nëse "ata shokët" janë duke ardhur. Ai u përgjigj "ata janë atje, a tu them atyre të vijnë?". Xh.T. i thotë atij që "t'u thotë atyre të vijnë". Ai e pyeti atë nëse ata duhet të vijnë "sonte apo nesër në mëngjes, cili është mendimi juaj?" Xh.T. i përgjigj duke thënë "është në rregull për nesër në mëngjes në ora 8 sepse sonte ata do të vonohen". Ai ia ktheu "OK, më mirë nesër rreth orës 8, por mua nuk më kujtohet vendi ku më ke thënë, e di fshatin por nuk më kujtohet vendi". Xh.T. i tha atij te restoranti "Albest" që gjendet në rrugë për Suharekë, ata do ta shohin atë". Ai tha "po, do t'u them atyre të jenë nesër atje në 8". Xh.T. përgjigjet duke thënë "OK në ora 8-8:30 në cfarëdo kohe që ata dëshirojnë.".

(57) **04.09.2009** në ora **21:01:42 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] ("Sy.") (*Dosja e përgjimeve XI, f.161-162*)

Një bashkëpunëtorë Shqiptar flet me Xh.T.-n duke diskutuar korierin prej Shqipërisë në Kosovë. Ai deklaroi "hej dajë, ai është atje te ti, por do të dërgoj numrin përmes SMS" Xh.T. tha, "OK dërgoje sepse do ta thërras në telefon".

(58) **04.09.2009** në ora **21:03:12 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.](*Dosja e përgjimeve XI, f.163)*

Bashkëpunëtori Shqiptar dërgoi numrin e korierit: numri 044 715 171 I përket G.I.T.

(59) **04.09.2009** në ora **21:06:09 [Tel. nr.]** Xh.T. duke thirrur [Tel. nr.] (G.I.) (*Dosja e përgjimeve XI, p.164*)

Xh.T. foli me G.I. i cili përdor numrin 044 715 171. G.G. I tha Xh.T. "Unë jam te [the] shitorja e dasmave, afër restorantit "Albest"". Xh.T. I tha atij të "pres sepse Brenda 5 minutave unë do të jem atje".

(60) **04.09.2009** në ora **21:15:50 [Tel. nr.]** Xh.T. thërret [Tel. nr.] (G.I.) (*Dosja e përgjimeve XI, f.166*)

Xh.T. I tha G.I. "qëndro aty ku je sepse tani vjen djali im te ju, OK, OK".

(61) **04.09.2009** në ora **21:17:42 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] ("Sy.") (*Dosja e përgjimeve XI, f.168-169*)

Xh.T. foli me një bashkëpunëtorë Shqiptar në numr telefoni [Tel. nr.], duke pyetur "dajë, dëgjomë, I kam takuar ata djem, ata kanë ardhur të pyesin nëse ata mund të sjellin, a të vijmë sonte për darkë ose nesër në mëngjes, cka duhet tu them këtyre djemve tani?" Ai tha t'u "them atyre kurdo që ata të dëshirojnë, ku, pse" Xh.T. I tha atij "Unë po të them ty nëse në mëngjes te ky vend". Ai I tha taij "kurdoherë që dëshiron, ti thuaju atyre kështu të pajtohemi për nesër".

(62) **05.09.2009** në ora **00:04:20 [Tel. nr.]** Xh.T. thërret [Tel. nr.] (A.K.) *(Dosja e përgjimeve XI, f.170-171)*

Xh.T. pyet A.K.-n nëse "ai e thirri atë apo jo?" A.K. thotë "Po pres sepse ai do të dërgojë SMS, ai duhet sepse ka ardhur koha dhe në cfarë kohe do të fillosh nesër?" Xh.T. tha "rreth orës 8". A.K. tha "OK, ne do të shkojmë për kafe dhe tani shko". Xh.T. pastaj i tha A.K. se "kur të shkruaj SMS ti më shkruan mua dhe mbaje telefonin hapur".

(63) **05.09.2009** në ora **09:08:37 [Tel. nr.]** Xh.T. thërret [Tel. nr.] (A.K.) (*Dosja e përgjimeve XI, pp.174-175*)

Xh.T. I thotë A.K. të "vjen për të pirë kafe te vendi ku e kemi përmendur më herët sepse më duhet të shkoj".

[Vendi i lënë i takimit është restoranti Albest siq është konfirmuar nga raporti I vëzhgimit I bërë nga Policia e Kosovës në atë ditë.]

(64) **05.09.2009** në ora **09:16:10 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] *(Dosja e përgjimeve XI, p.176).*

Xh.T. merr një SMS nga një bashkëpunëtorë Shqiptar shkruan "MURGENTAHL afër Arau", lokacion në Zvicërr,

(65) **05.09.2009** në ora **09:25:54 [Tel. nr.]** Xh.T. thërret [Tel. nr.] (V.G.) (*Dosja e përgjimeve XI, f.177*)

Xh.T. thotë: "Jam hidhëruar shumë, ata është dashur të vijnë mbrëmë por nuk kanë ardhur. Futjau".

(66) **05.09.2009** në ora **10:34:54 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] ("Sy.") (*Dosja e përgjimeve XI, pp.179-180)*

*Xh.T. Thaqi thirri S.T.-n . Xh.T. i thotë atij "Dikush tjetër I ka takuar ata sepse unë nuk kam dashru t'i takojë ata…ata kanë pasur një rrëmujë të vërtetë, njërëzit e mi, sepse njerëzt kanë shkuar pas tyre…[por] ai thotë që ata ja kanë dalë të ikun…kur e kanë parë që janë duke u ndjekur, ata e kanë ndërruar drejtimin".*

*Xh.T. delegoi detyrën për të takuar korierët që shkonin përpara tek anëtarët tjerë të grupit criminal në Kosovë nën kontrollin e tij.*

(67) **05.09.2009** në ora **11:37:29 [Tel. nr.]** Xh.T. i thirrur nga [Tel. nr.] [G.G.] *(Dosja e përgjimeve XI, f.186)*

*Xh.T. për G.G. ": I kam pyetur djemt, ata më thanë është qetësi tani…*
*…ai e la të GRUAN në rrugë, apo kupton? [duke menduar për drogën]*
*… Porn ë vend të sigurtë, a po kupton?*
*…ai e la atë aty dhe shkoi shpejt drejt një drejtimi tjetër, a kupton…*
*…ka qenë fat I vërtetë, dhe kur ju erdhët kësaj rruge…të shpresojmë që do të ketë qetësi të vërtetë dhe asgjë nuk ka ndodhur më vonë, apo kupton"*

